Fibank
First Investment Bank

FIRST INVESTMENT BANK - ALBANIA SH.A.

Pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
(dhe raporti i audituesit të pavarur)

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRAT FINANCIARE:	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	1
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022	2
Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	3-4
Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022	5-6
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	7 - 70

Grant Thornton

Grant Thornton Shpk
Rr. Sami Frasheri , kompleksi T.I.D
Hyrja B,Kati 1
1000 Tirana
Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Aksionarët dhe Bordin Drejtues të First Investment Bank – Albania Sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të First Investment Bank – Albania Sh.a. (më tej referuar si "Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2022, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2022 dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standarde të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.

- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Bankës.

- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Bankës të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare individuale, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tirana, Albania

27 mars 2023

Kledian Kodra, FCCA

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

në mijë Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Të ardhura nga interesat		1,938,415	1,580,647
Shpenzime për interesat		(406,051)	(420,252)
Të ardhura neto nga interesat	**6**	**1,532,364**	**1,160,395**
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		518,930	415,814
Shpenzime për tarifat dhe komisionet		(89,574)	(69,581)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet	**7**	**429,356**	**346,233**
Të ardhurat neto nga tregtimi	8	10,701	19,947
Të ardhura të tjera operative	9	6,731	118,255
Gjithsej të ardhura nga veprimtaria bankare		**1,979,152**	**1,644,830**
Humbje neto nga zhvlerësimi	18.1	(271,840)	(191,924)
Provizione për zërat jashtë bilancit, neto		(509)	(460)
Shpenzime personeli	10	(427,963)	(375,099)
Zhvlerësimi dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme	19,20	(125,015)	(120,155)
Shpenzime të përgjithshme administrative	11	(188,165)	(162,299)
Shpenzime të tjera, neto	12	58,847	(72,961)
		(954,645)	**(922,898)**
Fitimi / (Humbja) para tatimit		**1,024,507**	**721,932**
Tatimi mbi fitimin (shpenzim)/të ardhura	13	**(145,358)**	**(106,625)**
FITIMI/(HUMBJA) PER VITIN		**879,149**	**615,307**
Të ardhura / (humbje) gjithpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin		**(306,656)**	**(37,712)**
GJITHSEJ TE ARDHURA GJITHPËRFSHIRËSE PËR VITIN, QË I PËRKASIN AKSIONERËVE		**572,493**	**577,595**

Shënimet shoqëruese të paraqitura nga faqja 7 deri në faqen 70 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022
në mijë Lekë

	Shënime	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
AKTIVET			
Arka dhe Banka Qendrore	14	3,170,472	898,338
Shuma të kushtëzuara	15	3,268,442	2,713,545
Aktive financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	16	3,616,033	11,592,311
Aktive financiare të mbajtura me kosto të amortizuar	16	9,093,158	-
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	17	3,730,441	4,234,180
Hua dhe paradhënie për klientë	18	25,231,137	20,645,991
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	19	375,978	190,156
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	20	72,400	64,963
Aktive të mbajtura për shitje	21	618,407	547,372
Aktive me të drejtë përdorimi	19	826,518	891,809
Aktive të tjera	22	91,067	104,629
E drejtë për tatimin e shtyrë	13	28,235	-
GJITHSEJ AKTIVET		**50,122,288**	**41,883,294**
PASIVET DHE KAPITALI AKSIONER			
Detyrime ndaj bankave	23	3,182,229	424,467
Detyrime ndaj klientëve	24	38,869,160	34,332,798
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	25	453,452	886,539
Borxhi i varur	26	1,133,621	594,092
Detyrimi për qiranë	27	801,739	902,690
Detyrime të tjera	28	885,349	487,193
Detyrimi i tatimit të shtyrë	14	-	19,665
Gjithsej detyrimet		**45,325,550**	**37,647,444**
Kapitali i paguar	29	1,516,517	1,516,517
Rezerva ligjore	29	133,639	102,874
Rezerva të tjera	29	249,080	201,084
Rezervë rivlerësimi për investimet e mbajtura me VDATGj		(159,570)	158,691
Fitime të akumuluara		3,057,072	2,256,684
Kapitali aksioner		**4,796,738**	**4,235,850**
GJITHSEJ PASIVET DHE KAPITALI AKSIONER		**50,122,288**	**41,883,294**

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri në faqen 70 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
në mijë Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet operacionale			
Fitim neto për periudhën		**879,149**	**615,307**
Zërat jo monetarë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpëfshirëse			
Humbjet neto nga zhvlerësimi		272,349	192,384
Zhvleresimet dhe amortizimet	19,20	125,015	120,155
Të ardhurat neto nga interesat	6	(1,532,364)	(1,160,395)
Shpenzimi për tatimin mbi fitimin	13	145,358	106,625
(Fitim) / Humbje nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara		179	(95)
(Fitim) / Humbje nga shitja e aktiveve të tjera		(5,550)	(358)
të ardhura nga marrja në pronësi e kolateraleve për kreditë e fshira		(142,081)	-
		(257,945)	**(126,377)**
Ndryshimet në kapitalin qarkullues:			
(Rritje) në hua për klientët	18	(4,740,708)	(3,775,509)
Rënie në aktive të tjera		(15,334)	11,102
(Rritje) në rezervat e detyrueshme		(554,897)	(623,869)
Rritje në depozitat nga bankat		2,753,606	310,468
Rritje në detyrime ndaj klientëve		4,544,608	5,820,013
Rritje në detyrime të tjera		435,039	20,525
Interesi i paguar		(410,063)	(457,613)
Interesi i arkëtuar		1,826,695	1,557,820
Tatimi mbi të ardhurat i paguar	13	(148,299)	(61,470)
FLUKSET E PARASË (TË PËRDORURA PËR) / NGA AKTIVITETET OPERACIONALE		**3,432,702**	**2,675,090**
Flukset e parasë nga / (të përdorura për) aktivitetet investuese:			
Fluksi neto nga blerjet dhe maturimet e investimeve me kosto të amortizuar		(2,475,880)	-
Blerjet të investimeve me VDATGj		(8,051,200)	(14,797,400)
Shitje të investimeve me VDATGj		9,027,432	13,149,784
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	20	(25,209)	(16,208)
Blerje e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	19	(222,122)	(41,139)
Shitje e aktiveve të qëndrueshme		608	170
Shitje e aktiveve të tjera		83,090	22,371
FLUKSET E PARASË NGA / (TË PËRDORURA PËR) AKTIVITETET INVESTUESE, NETO		**(1,663,281)**	**(1,682,422)**

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
në mijë Lekë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese:			
Emetim / (ripagim) i borxhit të varur		539,153	(14,406)
(Rënie) / Rritje në huamarrje		(432,789)	885,918
Pagesa të detyrimit të qirasë		(107,390)	(85,976)
FLUKSET E PARASË (TË PËRDORURA PËR) / NGA AKTIVITETET FINANCUESE, NETO		**(1,026)**	**785,536**
RRITJA NETO E AKTIVET MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO GJATË VITIT		**1,768,395**	**1,778,204**
AKTIVET MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO NË FILLIM TË VITIT	**32**	**5,132,518**	**3,354,314**
AKTIVET MONETARE DHE EKUIVALENTE ME TO NË FUND TË VITIT	**32**	**6,900,913**	**5,132,518**

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri në faqen 70 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
në mijë Lekë

	Kapitali i paguar	*Rezerva*	*Fitimet e mbartura*	*Rezerva rivlerësimi për aktivet financiare të mbajtura me VDATGj*	*Gjithsej*
Gjëndja më 1 janar 2021	**1,516,517**	**266,894**	**1,678,441**	**184,738**	**3,646,590**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën:					
Fitimi i vitit	-	-	615,307	-	**615,307**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, para tatimit mbi fitimin	-	-	-	(26,047)	**(26,047)**
Gjithsej të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**615,307**	**(26,047)**	**589,260**
Veprime me aksionerët, të regjistruar direkt në kapital:					
Kontribute dhe shpërndarje:					
Kapital i paguar	-	-	-	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	-	-
Ndryshime në rezerva					
Rezerva ligjore	-	18,760	(18,760)	-	-
Rezerva të tjera	-	18,304	(18,304)	-	-
Gjithsej kontribute (nga) dhe shpërndarje (për) aksionerët	**-**	**37,064**	**(37,064)**	**-**	**-**
Gjëndja më 31 dhjetor 2021	**1,516,517**	**303,958**	**2,256,684**	**158,691**	**4,235,850**

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri në faqen 70 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Fibank
First Investment Bank

Pasqyra e ndryshimit të kapitalit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
në mijë Lekë

	Kapitali i paguar	*Rezerva*	*Fitimet e mbartura*	*Rezerva rivlerësimi për aktivet financiare të mbajtura me VDATGj*	*Gjithsej*
Gjëndja më 1 janar 2022	**1,516,517**	**303,958**	**2,256,684**	**158,691**	**4,235,850**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për periudhën:					
Fitimi i vitit	-	-	879,149	-	**879,149**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, para tatimit mbi fitimin	-	-	-	(318,261)	**(318,261)**
Gjithsej të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-			
Veprime me aksionerët e regjistruar direkt në kapital:					
Kontribute dhe shpërndarje:					
Kapital i paguar	-	-	-	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	-	-
Ndryshime në rezerva					
Rezerva ligjore	-	30,765	(30,765)	-	-
Rezerva të tjera	-	47,996	(47,996)	-	-
Gjithsej kontribute (nga) dhe shpërndarje (për) aksionerët	-	**78,761**	**(78,761)**	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2022	**1,516,517**	**382,719**	**3,057,072**	**(159,570)**	**4,796,738**

Shënimet shoqëruese nga faqja 7 deri në faqen 70 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi më 7 shkurt 2023 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:

Bozhidar Todorov
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

FIRST INVESTMENT BANK ALBANIA sh.a. 2

Elma Lloja
CRetO & Drejtor Ekzekutiv

Edvin Liko
Drejtor i Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit

1. Të përgjithshme

Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri sh.a. (Banka) e themeluar në Republikën e Shqipërisë është shoqëri aksionere më 1 gusht 2005 dhe i ka zyrat e saj qendrore në Tiranë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14-15.

Banka është e licensuar nga Banka e Shqipërisë (BSh), më 6 korrik 2007, në bazë të së cilës asaj i lejohet të kryejë të gjithë veprimet bankare të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Banka është kryesisht e përfshirë në shërbimet bankare të korporatave dhe atyre retail.

Banka gjithashtu është licensuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare për të kryer shërbimet e depozitarit, kujdestarit dhe brokerimit.

Banka është një filial i Bankës së Parë të Investimeve A.D. (më pas "Mëma"), një entitet i krijuar në Bullgari si institucion financiar e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. Para licensimit ajo operoi si një degë e huaj e Mëmës në Shqipëri që nga shkurti i vitit 1999.

Struktura e aksionarëve të Mëmës më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 është si më poshtë:

Aksionarët	% e kapitalit aksioner 31 dhjetor 2022	% e kapitalit aksioner 31 dhjetor 2021
Z. Ivailo Dimitrov Mutafchiev	31.36	31.36
Z. Tzeko Todorov Minev	31.36	31.36
Banka Bullgare per Zhvillim AD	18.35	18.35
Valea Foundation	7.87	7.87
Aksionerë të tjerë (aksionerë të cilët kanë aksione të cilat tregtohen në Tregun e Aksioneve Bullgare në-Sofie)	11.06	11.06
Totali	**100.00**	**100.00**

Zyrat qendrore të Bankës së Parë të Investimeve - SHQIPËRI sh.a. ndodhen në Tiranë. Rrjeti i degëve përfshin 14 degë. Katër degë ndodhen në Tiranë (Tirana 1, Tirana 2, Tirana 3, dhe Kullat Binjake) dhe degët e tjera ndodhen në: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Lezhë, Lushnjë, Korçë, Sarandë, Shkodër, dhe Vlorë.

Banka kishte 425 punonjës më 31 dhjetor 2022 (31 dhjetor 2021: 367). Numri mesatar i punonjësve për vitin që mbaron në 31 dhjetor 2022 është 392 (31 dhjetor 2021: 350).

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e parimit të vijëmësisë, pasi drejtimi vlerëson që Banka ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtimi merr në konsideratë një gamë të gjerë informacioni duke përfshirë parashikimet e përfitueshmërisë, kërkesat rregullatore për kapital dhe nevojat për financim. Vlerësimi përfshin gjithashtu shqyrtimin e skenarëve të arsyeshëm të mundshëm ekonomikë dhe ndikimet e tyre në përfitueshmërinë, kapitalin dhe likuiditetin e Bankës.

Detajet e politikave kontabël të Bankës përfshihen në Shënimin 3.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

b) Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj) të vlerësuara mbi bazën e vlerës së drejtë.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Bankës, ku shumat janë të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt.

Drejtimi ka zgjedhur monedhën Lekë, si monedhë funksionale të Bankës për faktin se Banka operon në një ambient në të cilin çmimet, në gjykimin e Drejtimit, janë të ndikuara nga monedha vendase Leku. Kostot dhe kontratat janë të ndikuara nga Leku, edhe nëse emërtimi i tyre formal, është në një monedhë të ndryshme.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që drejtimi të gjykojë, të bëjë vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e pasqyruara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë në bazë të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet mbi vlerësimet kontabël njihen në përiudhën në të cilën vlerësimi rishikohet, si dhe në çdo përiudhë të ardhme që vlerësimi ka ndikim.

A. Gjykimet

Informacioni mbi gjykimet e bëra në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare përfshihet në shënimet e mëposhtme.

- Shënimi 3 (f) (ii): klasifikimi i aktiveve financiare: vlerësimi i modelit të biznesit brenda të cilit mbahen aktivet dhe vlerësimi nëse kushtet kontraktuale të aktivit financiar parashikojnë flukse monetare të cilat përbëhen vetëm nga pagesa të principalit dhe interesit.
- Shënimi 4 (c): vendosja e kritereve për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë mbi aktivin financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, përcaktimi i metodologjisë për përfshirjen e informacionit të parashikuar në matjen e humbjeve të pritshme të kredisë (HPK) dhe përzgjedhjen dhe miratimin e modeleve të përdorura për matjen e HPK-së.

B. Supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material në vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 përfshihet në shënimet e mëposhtme.

- Shënimi 4 (c): zhvlerësimi i instrumenteve financiare: përcaktimi i të dhënave në modelin e zhvlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë, duke përfshirë dhe informacionin për kushtet e ardhshme
- Shënimi 3 (f) (vii): përcaktimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare me të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme
- Shënimi 3 (e) (ii): njohja e aktiveve tatimore të shtyra
- Shënimi 3 (o): njohja dhe matja e detyrimeve të kushtëzuara: supozimi kryesor për gjasat dhe madhësinë e një fluksi në dalje të burimeve
- Shënimi 3 (l): vlera neto e realizueshme e inventarit: matja e vlerës së drejtë me të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme
- Shënimi 3 (f) (viii): zhvlerësimi i instrumenteve financiare: supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e flukseve të mjeteve monetare që mund të rikuperohen.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale të Bankës me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të nominuara në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale në atë datë. Humbja ose fitimi nga këmbimet valutore i mjeteve monetare është diferenca ndërmjet kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedha të huaja të këmbyera me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë matur me vlerë të drejtë në monedha të huaja këmbehen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Mjetet jo-monetare të cilat maten me kosto historike në monedhë të huaj këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit përgjithësisht njihen në fitim ose humbje.

b) Interesat

Norma efektive e interesit

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën e interesit efektiv. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të instrumenteve financiare deri në:

- Shumën e mbartur bruto të aktivit financiar; ose
- Koston e amortizuar të detyrimit financiar

Për llogaritjen e normës efektive të interesit për instrumentet financiare përveç aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara, Banka vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhmen duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo HPK-të. Për aktivet financiare me kredit të zhvlerësuar të blera apo të krijuara, norma efektive e interesit e rregulluar llogaritet duke përdorur rrjedhën e parasë të vlerësuar, përfshirë HPK-të.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte blerjes, emetimit ose shitjes se një aktivi ose detyrimi financiar.

Kostoja e amortizuar dhe vlera kontabël bruto

'Kosto e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare dhe shumës në maturim dhe, për aktivet financiare, përshtatur për çdo zhvlerësim të pritshëm për humbjen nga kreditë. Shuma 'bruto e mbartur e një aktivi financiar' është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar përpara se të korrigjohet për çdo zhvlerësim për humbjet të pritshme të kredisë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

b) Interesat (vazhdim)

Llogaritja e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi

Norma efektive e interesit të një aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare të aktivit financiar ose detyrimit financiar. Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të interesit, norma efektive e interesit zbatohet mbi shumën e mbartur bruto të aktivit (nëse aktivi nuk zhvlerësohet) ose për koston e amortizuar të detyrimit. Norma efektive e interesit rishikohet si rezultat i rivlerësimit periodik të flukseve të mjeteve monetare ose instrumenteve me normë të ndryshueshme për të pasqyruar lëvizjet në normat e interesit të tregut.

Megjithatë, për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit për koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk vazhdon të zhvlerësohet më tej, atëherë matja e të ardhurave nga interesi do të bëhet në bazë të vlerës bruto.

Për aktivet financiare të cilat janë zhvlerësuar në fazën e njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi maten duke zbatuar normën efektive të interesit të rregulluar të kredisë ndaj kostos së amortizuar të aktivit. Matja e të ardhurave nga interesi nuk zbatohet sipas metodës për shumën bruto, edhe nëse rreziku i kredisë së aktivit përmirësohet.

Për informacion mbi kur aktivet financiare janë me kredit të zhvlerësuar, shih Shënimin 3(g)(viii).

c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv të një aktivi ose pasivi financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat e tjera nga tarifat dhe komisionet, përfshirë tarifat e shërbimit të llogarisë, tarifat e menaxhimit të investimeve, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen kur kryhen shërbimet e lidhura me to. Nëse angazhimi për një hua nuk pritet të zvogëlojë huan, atëherë komisionet e angazhimit të huas njihen në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së angazhimit.

Një kontratë me një klient që rezulton në një instrument financiar të njohur në pasqyrat financiare të Bankës mund të jetë pjesërisht në fushën e SNRF 9 dhe pjesërisht në fushën e SNRF 15. Nëse është kështu, atëherë Banka së pari aplikon SNRF 9 për të ndarë dhe matur pjesën e kontratës që është në fushën e SNRF 9 dhe më pas zbaton SNRF 15 për pjesën e mbetur.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera nga tarifat dhe komisionet lindin nga shërbimet financiare të kryera nga Banka dhe njihen kur shërbimi përkatës ofrohet ose merret.

d) Të ardhura neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përbëhen kryesisht nga fitimet duke zbritur humbjet të realizuara dhe të parealizuara nga diferencat në kurset e këmbimit.

3 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

e) Shpenzime për tatimin mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në fitim ose humbje përveçse kur lidhet me zërat për të cilat njihet direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet mbi fitimin e tatueshëm ose humbjen për vitin, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe cdo korrigjim për taksat e pagueshme nga vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës kontabël të përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve dhe detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinin biznesi dhe që nuk ndikon as fitimin ose humbjen kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do të ndiqnin mënyrën që Banka pret për të rikuperuar vlerën e mbartur te aktiveve dhe pasiveve të saj, në fund të periudhës së raportimit.

Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të cilat pritet të aplikohen në diferencat e përkohëshme kur ato ndryshojnë bazuar në ligjet të cilat janë miratuar ose priten të miratohen në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve netohet nëse ka një detyrim ligjor për të netuar tatimin aktual të pasiveve me tatimin aktual të aktiveve, dhe ato lidhen me tatimin mbi të ardhurat që jepet nga i njëjti autoritet tatimor për të njëjtën njësi ekonomike të tatueshme.

Tatimi i shtyrë i aktiveve njihet për humbjet fiskale të mbartura dhe të papërdorura, tatimin e krediturar dhe diferenca të përkohëshme të zbritshme në atë masë që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të përdoren, ndaj të cilave ato mund të mundësohen. Tatimi i shtyrë i aktiveve rishikohet në çdo datë raportimi dhe ulet në atë masë që nuk është e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimi tatimor

Në përcaktimin e vlerës së tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë, Banka merr në konsideratë efektin e situatave të pasigurta nga ku mund të lindin detyrime shtesë në lidhje me taksat. Ky vlerësim bazohet në supozime dhe parashikime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh mbi ngjarje të së ardhmes. Informacione të reja të mundshme mund të bëjnë Bankën të ndryshojë gjykimin e saj përsa i përket saktësisë së detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të mundshme në detyrimet tatimore do të ndikonin shpenzimin për tatimin në periudhen në të cilën ky konstatim do të bëhej.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huatë dhe paradhëniet, depozitat, instrumentat e borxhit dhe borxhin e varur në datën kur ato janë krijuar. Mënyrat e rregullta të blerjes dhe shitjes së aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka kryen blerjen ose shitjen e aktiveve. Të gjithë aktivet dhe detyrimet financiare e tjera fillimisht njihen në datën kur Banka bëhet palë kontraktuale e një instrumenti.

Një aktiv ose detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit të cilat kanë të bëjnë direkt me blerjen ose emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Në njohjen fillestare, Banka e klasifikon një aktiv financiar si të matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse VDATGj ose vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes VDPFH.

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes:

- aktivi mbahet në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është që të mbajë aktivet për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale;
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar sjellin në datat e specifikuara flukse monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit

Një detyrim financiar matet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktohet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes:

- aktivi mbahen brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet nga arkëtimi i flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e aktiveve financiare;
- kushtet kontraktuale të aktivit financiar sjellin në datat e specifikuara flukse monetare të cilat vijnë vetëm nga pagesa të principalit dhe të interest.

Në fazën e njohjes fillestare të një investimi në instrumente të kapitalit neto i cili nuk mbahet për qëllime tregtimi, Banka në mënyrë të parevokueshme mund të vendos të paraqesë ndryshimet në vijim me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Ky vendim merret rast pas rasti sipas investimeve.

Të gjitha aktivet e tjera financiare klasifikohen si të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes VDPFH.

Gjithashtu, në fazën e njohjes fillestare, Banka në mënyrë të parevokueshme mund të vendos që një aktiv financiar, i cili i plotëson kushtet të matet me kosto të amortizuar ose me VDATGj, ta masë me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse në këtë mënyrë eliminon ose zvogëlon ndjeshëm papajtueshmërinë kontabël që mund të rezultojë në të kundërt.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka ka bërë një vlerësim të qëllimit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në nivel portofoli sepse pasqyron më mirë mënyrën e manaxhimit të biznesit dhe të paraqitjes së informacionit ndaj drejtimit. Informacioni që është marrë në konsideratë përfshin:

- politikat dhe objektivat për portofolin dhe zbatimin e këtyre politikave në praktikë, duke përfshirë, nëse strategjia e menaxhimit fokusohet në përfitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesat, mbajtja e një profili të caktuar normash interesi, përputhja e maturitetit të aktiveve financiare me maturitetin e detyrimeve që financojnë këto aktive apo realizojnë flukse monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- mënyrën e vlerësimit të ecurisë së portofolit dhe raportimit tek drejtimi i Bankës;
- risqet që cënojnë ecurinë e modelit të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura sipas këtij modeli biznesi) dhe strategjia për mënyrë e menaxhimit të këtyre rreziqeve:
- si kompensohen drejtuesit e njësisë - p.sh. nëse kompensimi është bazuar në flukset monetare kontraktuale të mbledhura apo fitimi total i realizuar nga portofoli, dhe
- shpeshtësinë, volumin dhe kohën e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për këto shitje, dhe pritshmëritë e saj për aktivitetin e shitjeve në të ardhme. Megjithatë, informacioni dhe të dhënat për aktivitetin e shitjes nuk vlerësohet në mënyrë të izoluar, por si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të mënyrës së arritjes nga ana e Bankës të objektivave të deklaruar për drejtimin e aktiveve financiare dhe realizimit të flukseve monetare.

Aktivet financiare që mbahen për tregtim, performanca e të cilave vlerësohet në bazë të vlerës së drejtë maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes sepse ato nuk mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale e as nuk mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe për të shitur aktivet financiare.

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale përbëhen vetëm nga pagesa të principalit dhe interesit.

Për qëllime të këtij vlerësimi, 'principali' përkufizohet si vlera e drejtë e një aktivi financiar në njohjen fillestare. Interesi përkufizohet si pagesa për vlerën në kohë të parasë dhe për riskun e kredisë që shoqëron shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për rreziqet dhe kostot e tjera kryesore të kredidhënies, si dhe marzhin e fitimit.

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, Banka do të konsiderojë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohën apo shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë vlerësimit, Banka merr në konsideratë:

- ngjarjet e kushtëzuara që do të ndryshojnë shumën dhe kohën e flukseve të mjeteve monetare; karakteristikat e levës financiare; parapagimin dhe zgjatjen e afateve;
- afatet që kufizojnë pretendimet e Bankës për flukse monetare për aktive të veçanta (p.sh. hua jorekurs);
- dhe karakteristikat që modifikojnë pagesën e vlerës kohë të parasë (p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit).

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Riklasifikimet

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të Bankës për drejtimin e aktiveve financiare.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, të matura me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit/humbjes. Shiko politikën e kontabilitetit 3.o.

(iii) Çregjistrimi

Aktivet Financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar. Çdo interes në transferimin e aktiveve financiare që krijohet ose mbahet nga Banka njihen si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e aktiveve të transferuara, apo ndonjë pjesë të tyre. Në këto raste, aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Si shembull të këtyre transaksioneve përmendim huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes. Për transaksionet në të cilat Banka as nuk mban as nuk transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së një aktivi financiar, ajo çregjistron aktivin nëse nuk mban kontrollin mbi aktivin. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim njihen veçmas si aktive dhe pasive sipas rastit. Në transfertat në të cilat ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar nga shkalla në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

Në transaksione të caktuara, Banka ruan të drejtat për të kryer ose marrë shërbime për një aktiv financiar të transferuar kundrejt një tarife. Aktivet e transferuara çregjistrohen tërësisht nëse plotësojnë kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet për kontratën e shërbimit, varësisht nga fakti nëse tarifa e shërbimit është më shumë se e përshtatshme (aktivi) ose është më e vogël se sa adekuate (detyrimi) për kryerjen e shërbimit. Banka fshin kredi të caktuara kur ata përcaktohet se ato janë të pa arkëtueshme (shih shënimin 4.c).

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një pasiv financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shfuqizohen, anulohen ose skadojnë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare të modifikuara

Aktivet financiare

Nëse kushtet e një aktivi financiar ndryshojnë, atëherë Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të aktivit të modifikuar janë në thelb të ndryshme.

Nëse flukset e mjeteve monetare janë thelbësisht ndryshe, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e mjeteve monetare nga aktivi financiar fillestar, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, aktivi financiar origjinal nuk njihet (shih iii) dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë plus çdo kosto të pranueshme të transaksionit. Çdo tarifë e marrë si pjesë e modifikimit kontabilizohet si vijon:

- tarifat që lidhen me përcaktimin e vlerës së drejtë të aktivit të ri dhe tarifat që përfaqësojnë rimbursimin e kostove të pranueshme të transaksionit përfshihen në vlerën fillestare të aktivit; dhe
- Tarifat e tjera përfshihen në fitim ose humbje si pjesë e fitimit ose humbjes që rezulton nga çregjistrimi i aktivit.

Nëse flukset e mjeteve monetare ndryshojnë kur huamarrësi është në vështirësi financiare, atëherë objektivi i modifikimit është zakonisht për të maksimizuar rikuperimin e kushteve kontraktuale origjinale në vend të origjinimit të një aktivi të ri me kushte thelbësisht të ndryshme. Nëse Banka planifikon të modifikojë një aktiv financiar në një mënyrë që do të rezultonte me faljen e flukseve të mjeteve monetare, atëherë së pari konsideron nëse një pjesë e aktivit duhet të fshihet para se të bëhet modifikimi (shih më poshtë për politikën e fshirjes nga bilanci). Kjo qasje ndikon në rezultatin e vlerësimit sasior dhe do të thotë që kriteret e çregjistrimit zakonisht nuk plotësohen në raste të tilla.

Nëse modifikimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nuk rezulton në çregjistrimin e aktivit financiar, atëherë Banka rillogarit përsëri vlerën e mbartur bruto të aktivit financiar duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të aktivit dhe njeh rregullimin rezultues si një fitim ose humbje modifikimi në fitim ose humbje. Për aktivet financiare me normë të luhatshme, norma fillestare efektive e interesit e përdorur për të llogaritur fitimin ose humbjen e modifikimit rregullohet për të pasqyruar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit.

Çdo kosto ose komision që paguhet dhe komisionet që arkëtohen si pjesë e modifikimit rregullojnë vlerën e mbartur bruto të aktivit financiar të modifikuar dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të aktivit financiar të modifikuar.

Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit (shih 3.g. (viii)), atëherë të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhur nga interesi e llogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit (shih 3 (b)).

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iv) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare të modifikuara (vazhdim)

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij ndryshojnë dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Në këtë rast, një detyrim financiar i ri, bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë. Diferenca midis vlerës së mbartur të detyrimit financiar të çregjistruar dhe vlerës së paguar njihet në pasqyrën e fitim humbjeve. Pagesa e kryer përfshin aktivet jofinanciare të transferuara, nëse ka, dhe supozimin e detyrimeve, duke përfshirë detyrimin financiar të ri të modifikuar.

Nëse modifikimi i një detyrimi financiar nuk llogaritet si çregjistrim, atëherë kostoja e amortizuar e detyrimit llogaritet duke skontuar flukset e modifikuara të mjeteve monetare me normën fillestare të interesit efektiv dhe të ardhurat ose shpenzimet që rezultojnë njihen në pasqyrën e fitim humbjeve. Për detyrimet financiare me norma të luhatshme, norma fillestare efektive e interesit e përdorur për të llogaritur të ardhurat ose shpenzimet për modifikimin rregullohet për të pasqyruar kushtet aktuale të tregut në kohën e modifikimit. Të gjitha kostot dhe komisionet që paguhen njihen si një rregullim i shumës së mbartur të detyrimit dhe amortizohen gjatë afatit të mbetur të detyrimit financiar të modifikuar duke rikalkuluar normën efektive të interesit të instrumentit.

(v) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i arkëtojë dhe t'i shlyejë me bazë netimi ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standartet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme sic janë ato për aktivitetet e tregtimit nga Banka.

(vi) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, shtuar ose zbritur amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(vii) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim të shlyhet midis palëve që kanë njohuri dhe mundësi të kryejnë një transaksion në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes.

Kur është e mundshme, Banka e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur cmimet e kuotuara të një tregu aktiv për atë instrument. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuara janë lehtësisht dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale të tregut dhe që ndodhin rregullisht.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Matja me vlerë të drejtë (vazhdim)

Nëse tregu për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka përllogarit vlerën e drejtë duke përdorur një metodë vlerësimi. Metoda e vlerësimit përfshin përdorimin e transaksioneve të ndodhura së fundmi në kushte normale tregu midis palëve që kanë pasur si njohurinë dhe dëshirën (nëse është e disponueshme), përdorimin si referencë të vlerës së drejtë aktuale të instrumentave të tjerë që janë kryesisht të njëjtë, flukset monetare të skontuara si dhe modelet opsionale të cmimit. Metoda e zgjedhur e vlerësimit merr në konsideratë sa më shumë që të jetë e mundur të dhënat e tregut, mbështetet sa më pak të jetë e mundur në përllogaritjet specifike të Bankës, merr parasysh të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e cmimit dhe është konsistente me metodologjitë ekonomike të pranuara për vendosjen e cmimit të instrumentave financiare. Faktorët e metodave të vlerësimit paraqesin pritshmëritë e tregut dhe matjet e faktorëve të rreziqeve të trashëguara në instrumentat financiarë. Banka kalibron metodat e vlerësimit dhe i teston ato për vlefshmëri duke përdorur çmime të vëzhguara në transaksionet aktuale të tregut në instrumenta të njëjtë ose në të dhëna të tjera të vëzhgueshme në treg.

Evidenca më e mirë për vlerën e drejtë të një instrumenti financiar në matjen fillestare është çmimi i transaksionit, që do të thotë vlera e drejtë e dhënë ose e marrë, nëse nuk është i mundur, evidentimi i vlerës së drejtë të atij instrumenti nga krahasimi me transaksione të tjera të ndodhura në treg për instrumenta të njëjtë (pa modifikime) ose mund të bazohet në metoda vlerësimi faktorët e ndryshueshëm të të cilave përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në tregje. Kur cmimet e transaksioneve paraqesin evidencën më të mirë të vlerës së drejtë në njohjen fillestare, instrumenti financiar matet fillimisht me cmimin e transaksionit dhe cdo diferencë midis këtij cmimi dhe vlerës fillestare të përftuar nga një model vlerësimi njihët më pas në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit por jo më vonë se sa kur vlerësimi të mbështetet tërësisht nga të dhëna të vëzhgueshme në treg ose transaksioni është mbyllur.

Aktivet dhe pozicionet afatgjata maten me çmimin e ofruar, detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra maten me çmimin e kërkuar. Kur Banka ka pozicione me rreziqe që kompensojnë njëri tjetrin, cmimet "mid-market" përdoren për të matur pozicionin e rreziqeve të kompensuara dhe cmimi i kërkuar ose ofruar axhustohet, vetëm për pozicionet e hapura neto. Vlera e drejtë reflekton rrezikun e kreditimit të instrumentave dhe përfshin korrigjime të cilat marrin parasysh rrezikun e kreditimit të Bankës dhe të kundërpartisë tjetër kur është e përshtatshme. Llogaritjet e vlerës së drejtë të përftuara nga modelet korrigjohen për faktorë të tjerë si rreziku i likuiditetit ose pasiguritë e modeleve, në atë masë që Banka beson që një palë e tretë pjesëmarrëse në treg do t'i merrte ato në konsideratë për vendosjen e çmimit të një transaksioni.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Zhvlerësimi

Banka njeh humbjet nga zhvlerësimi për humbjet e pritshme të kreditit për instrumentet financiare të mëposhtëm që nuk janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit humbjes:

- aktivet financiare që janë instrumente borxhi;
- kontratat e garancisë financiare të lëshuara; dhe
- angazhimet e huasë të dhëna.

Banka mat humbjet nga zhvlerësimi në një shumë të barabartë me HPK-të përgjatë gjithë jetës, përveç sa vijon, për të cilën ato maten si humbje të pritshme të kredisë 12-mujore:

- instrumenta financiarë që përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit; dhe
- instrumenta të tjerë financiarë në të cilët rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare.

Banka e konsideron një instrument borxhi me rrezik të ulët kredie në momentin kur vlerësimi i rrezikut të kredisë për të është ekuivalent me përkufizimin global të "nivelit të investimeve". Banka nuk zbaton përjashtimin e rrezikut të ulët të kredisë për asnjë instrument financiar tjetër.

HPK-të për 12 muaj përbëjnë pjesën e humbjeve të pritshme të kredisë që rezultojnë nga ngjarjet e mospagimit për një instrument financiar që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Instrumentet financiare për të cilat llogaritet një HPK për 12 muaj njihen si 'Instrumentet financiare të nivelit 1'.

HPK-të përgjatë gjithë jetës përbëjnë humbjet e pritshme të kredisë që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë kohëzgjatjes së pritshme të instrumentit financiar. Instrumentet financiare për të cilat njihet një HPK përgjatë gjithë jetës, por që nuk janë me kredit të zhvlerësuar, referohen si 'Instrumentet financiare të nivelit 2'.

Matja e humbjeve të pritshme të kredisë (HPK)

HPK-të janë një vlerësim i probabilitet të ponderuar të humbjeve të kredisë. Ato maten si më poshtë:

- aktivet financiare që nuk zhvlerësohen në datën e raportimit: si vlera aktuale e të gjithë mjeteve monetare (dmth. diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe fluksin e parasë që Banka pret të marrë) ;
- aktivet financiare që zhvlerësohen në datën e raportimit: si diferencë midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara;
- huadhënie të aprovuara por jo të disbursuara: si vlera aktuale e diferencës ndërmjet flukseve të mjeteve monetare kontraktuale që i takojnë Bankës nëse huaja disbursohet dhe flukset monetare që Banka parashikon të arkëtojë; dhe
- kontratat e garancisë financiare: pagesat e pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të rikuperojë.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktivet financiare të zhvlerësuara

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse aktivet financiare që maten me kosto të amortizuar dhe aktivet financiare të borxhit që maten me VDATGj janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar zhvlerësohet nëse ka ndodhur një ose më shumë ngjarje të cilat kanë pasur një ndikim jo të favorshëm në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara të aktivit.

Treguesi që një aktiv financiar është zhvlerësuar përfshin të dhënat e mëposhtme të verifikueshme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare të huamarrësit ose emetuesit;
- një shkelje të kontratës siç janë ngjarjet e mospagesës ose vonesat;
- ristrukturimin e një huaje ose paradhënieje nga Banka sipas kushteve që Banka nuk do të konsideronte në një situate tjetër;
- tregues që një huamarrës do të falimentojë ose do të jetë subjekt i riorganizimit financiar;

Ose

- Zhdukja e një tregu aktiv për një aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare

Një hua që është rinegocuar për shkak të përkeqësimit të kushteve të huamarrësit në përgjithësi konsiderohet me kredit të zhvlerësuar, me përjashtim të rastit kur ekzistojnë treguese që rreziku i mosarkëtimit të flukseve monetare kontraktuale është ulur ndjeshëm dhe nëse nuk ka asnjë tregues tjetër të zhvlerësimit. Në vlerësimin nëse një investim në borxhin shtetëror është zhvlerësuar, Banka merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Vlerësimin e besueshmërisë së tregut, sikundër pasqyrohet në normat e kthimit të obligacioneve.
- Vlerësimet e agjencive të vlerësimit të aftësisë kreditore.
- Aftësia e vendit për të hyrë në tregjet e kapitalit për emetim të borxhit të ri.
- Mundësia e ristrukturimit të borxhit, duke rezultuar në humbjet për mbajtësit nëpërmjet faljes vullnetare ose të detyrueshme të borxhit.
- Miratimi i mekanizmave ndërkombëtare të mbështetjes për t'i ofruar vendit mbështetjen e nevojshme si "kreditor i zgjidhjes së fundit", si dhe qëllimi, i reflektuar në deklaratat publike të qeverive dhe agjencive për të përdorur këto mekanizma. Kjo përfshin një vlerësim të thellësisë së këtyre mekanizmave dhe, pavarësisht nga qëllimi politik, nëse kanë kapacitetin për të plotësuar kriteret e duhura.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Aktivet financiare të zhvlerësuara (vazhdim)

Paraqitja e zhvlerësimit për humbjet e pritshme të kredisë në pasqyrën e pozicionit financiar

Zhvlerësimet për HPK-të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- *aktivet financiare të matura me koston e amortizuar:* si zbritje nga vlera kontabël bruto e aktiveve;
- *kontratat për angazhimet e huasë dhe garancisë financiare:* në përgjithësi, si provizione;
- *kur një instrument financiar përfshin elementin e disbursuar dhe të padisbursuar, dhe Banka nuk mund të identifikojë humbjen e pritshme të kredisë për elementin e angazhimit të kredisë veçmas nga ato për elementin e disbursuar:* Banka paraqet një zbritje për humbje të kombinuar për të dy elementët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e elementit të disbursuar. Çdo tejkalim i zbritje për humbje nga zhvlerësimi mbi shumën bruto të elementit të disbursuar paraqitet si një provizion; dhe
- *Instrumentet e borxhit të matur me VDATGj:* asnjë zbritje për humbje nga zhvlerësimi nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera kontabël e këtyre aktiveve është vlera e drejtë e tyre. Megjithatë zhvlerësimi i humbjes paraqitet dhe njihet në rezervën e vlerës së drejtë.

Fshirja

Huatë dhe letrat me vlerë të borxhit fshihen (pjesërisht ose plotësisht) nëse nuk ka asnjë pritshmëri të arsyeshme për rikuperimin e aktivit financiar në tërësinë e tij ose të një pjese të tij. Në përgjithësi është rasti kur banka vendos nëse huamarrësi nuk ka aktive ose burime të të ardhurave të cilat mund të gjenerojnë flukse monetare të mjaftueshme për të ripaguar shumat që janë subjekt i fshirjes. Vlerësimi realizohet në nivelin e aktivit individual. Rikuperimi i shumave të fshira më parë përfshihen në "zhvlerësimin e humbjeve të instrumenteve financiare" në pasqyrën e fitim humbjeve dhe tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Aktivet financiare që janë fshirë mund të vijojnë të jenë ende subjekt i aktiviteteve të ekzekutimit të garancisë në zbatim të procedurave të Bankës për rikuperimin e shumave që duhet të paguhen.

g) Aktive monetare dhe ekuivalentet me to

Aktivet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë gjëndjen në arkë, depozitat me Bankën Qendrore dhe investimet me likuiditet të lartë të cilat kanë maturim tre mujor ose më të vogël.

h) Huatë dhe paradhëniet për klientët

Zëri i huave dhe paradhënieve në pasqyrën e pozicionit financiar përfshin huatë dhe paradhëniet e matura me kosto të amortizuar. Ato maten në fillim me vlerën e drejtë plus kostot e tjera të transaksioneve direkte dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të rishitur aktivin (ose një aktiv të konsiderueshëm të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme (marrëveshje e anasjelltë riblerje ose huadhënie të siguruara nga letrat me vlerë), marrëveshja kontabilizohet si një hua ose paradhënie, dhe aseti në fjalë nuk paraqitet në pasqyrat financiare të Bankës.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

i) Investimet në letra me vlerë

Zëri "letra me vlerë të investimit" në pasqyrën e pozicionit financiar përfshin:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që maten me kosto të amortizuar (shih f (ii)); këto maten në fillim me vlerën e drejtë plus kostot e tjera të transaksioneve direkte dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv
- letra me vlerë të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse;

Për titujt e borxhit të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, fitimet dhe humbjet njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse përveç zërave në vijim, të cilat njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar:

- Të ardhurat nga interesi duke përdorur metodën e interesit efektiv
- humbjet e pritshme të kredisë dhe rimarrjet, dhe
- Fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit

Kur investimet e borxhit të matur me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse çregjistrohen, fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohet nga kapitali në fitim ose humbje.

j) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara janë matur me koston e blerjes duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi. Jetëgjatësia e përdorimit llogaritet në bazë të pritshmërisë së Drejtimit për jetëgjatësinë e aktivit.

Amortizimi llogaritet me metodën lineare me normat e parashikuara për të ulur koston ose vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara përgjatë jetës së pritshme të përdorimit. Jetëgjatësitë e pritshme të përdorimit janë si më poshtë:

Përmirësime në aktivet e marra me qira	5-50 vjet
Paisje dhe instalime	10 vjet
Automjete	10 vjet
Makineri dhe paisje elektronike	10 vjet
Kompjutera dhe paisje informatike	5 vjet
Paisje të tjera zyre	10 vjet

Aktivet nuk amortizohen derisa ato futen në përdorim dhe transferohen nga aktive të qëndrueshme në proces në kategorinë përkatëse të aktiveve.

k) Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet me metodën lineare mbi jetën e përdorimit të aktivit. Jeta e përdorimit është si më poshtë:

Patenta dhe licenca	5 vjet
Programe kompjuterike dhe aktive të tjera të patrupëzuara	5 vjet

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

l) Aktive të mbajtura për shitje

Aktivet e përftuara nëpërmjet ekzekutimit të kolateraleve të huave dhe paradhënieve të klientëve, që nuk mbahen për shitje, nuk përfitohet qira, nuk përdoren dhe mbahen me qellimin tu nxjerr jashtë përdorimit në një periudhë të shkurtër kohe, pa një risktrukturim të rëndësishëm klasifikohen si inventar. Aktivet e perftuara paraqiten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme dhe cdo fshirje njihet në të ardhura apo shpenzime. Çdo fitim apo humbje nga nxjerrja jashte perdorimit njihet në të ardhura apo shpenzime.

m) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve tatimore të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rekuperueshme e aktivit.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen nëse vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese të aktiveve monetare tejkalon vlerën e rekuperueshme. Njësia gjeneruese e aktiveve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në të ardhura dhe shpenzime. Humbjet nga zhvlerësimi në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare shpërndahet në fillim duke ulur vlerën kontabël të emrit të mirë të shpërndarë tek njësitë dhe pastaj shpërndahet vlera kontabël e aktiveve të tjera në njësi (grupin e njësive) në një bazë propocionale.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose njësie gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet vlerës së përdorimit dhe vlerës së drejtë minus koston e shitjes. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të parashikuara të aktiveve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

n) Depozitat

Depozitat janë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë hyn në një marrëveshje për të ri-blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në një datë të ardhshme, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit. Depozitat, letra me vlerë të borxhit dhe borxhi i varur maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv përveçse në rastet kur Banka zgjedh që ti mbajë detyrimet me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave ose shpenzimeve.

o) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para tatimit e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Çështjet e lidhura me klimën

Rreziku i shkaktuar nga ndryshimet klimatike mund të ketë efekte negative në të ardhmen në aktivitetin e Bankës. Këto rreziqe përfshijnë rreziqet e tranzicionit (ndryshimet rregullatore dhe rrezikun e reputacionit) dhe rreziqet fizike (edhe nëse rreziku i dëmtimit fizik është i ulët për shkak të aktiviteteve të Bankës dhe vendndodhjeve gjeografike). Akiviteti I Bankës mund të ndikohet nga rregullat dhe ndryshimet e reja.

Njësoj si dhe vitin e kaluar, më 31 dhjetor 2022, Banka nuk ka identifikuar rreziqe të rëndësishme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike që mund të ndikojnë negativisht dhe materialisht në pasqyrat financiare të saj. Drejtimi vlerëson vazhdimisht ndikimin e çështjeve të lidhura me klimën në aktivitetin e Bankës.

Supozimet mund të ndryshojnë në të ardhmen në përgjigje të rregulloreve të ardhshme mjedisore dhe rregullatore dhe angazhimeve të reja të marra. Këto ndryshime, nëse nuk parashikohen, mund të kenë ndikim në flukset e ardhshme të parasë së bankës, performancën financiare dhe pozicionin financiar.

q) Standardet, interpretimet dhe ndryshimet e reja që ende nuk janë efektive

Standarde të reja dhe ndryshime të standardeve kanë hyrë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janarit 2022 dhe lejohet zbatimi prapaveprues; megjithatë, Banka nuk ka zbatuar standarde e reja dhe të ndryshuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Standardet e reja dhe të ndryshuara në vijim nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Bankës:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Ndryshimet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet në SNRF 17 dhe SNRF 4).
- Klasifikimi i detyrimeve si korrente ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1).
- Dhënia e informacioneve shpjeguese për politikat kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF 2 Deklarata e Praktikës).
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 1).
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime në SNK 8).

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut

Më poshtë paraqiten llojet e ndryshme të rrezikut ndaj të cilave Banka është e ekspozuar si rezultat i aktiviteteve jo-tregtare dhe përqasja e ndërmarrë për të menaxhuar këto rreziqe.

a) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit lind në financimet e përgjithshme të aktiviteteve të Bankës dhe në menaxhimin e pozicioneve. Ai përfshin si rrezikun e paaftësisë për të financuar aktivet me maturitet dhe norma të përshtatshme ashtu edhe rrezikun e paaftësisë për të likuiduar një aktiv me një çmim dhe brenda një afati kohor të arsyeshëm për të përmbushur detyrimet.

Fondet krijohen duke përdorur një sërë instrumentash duke përfshirë depozitat dhe kapitalin e paguar. Kjo rrit fleksibilitetin e fondeve, kufizon varësinë nga një burim i vetëm financimesh dhe përgjithësisht ul koston e fondeve. Banka përpiqet për të ruajtur balancën midis vazhdimësisë së fondeve dhe fleksibilitetit, nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të shpërndara në kohë. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet e duhura në financime, në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vendosura në strategjinë e Bankës. Më 31 dhjetor 2022 tridhjetë depozituesit jo-financiarë më të mëdhenj përbëjnë 18.54% (2021: 13.01%) të totalit të depozitave nga klientët.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet një analizë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas grupimeve përkatëse të maturitetit bazuar në periudhat e mbetura të shlyerjeve.

Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2022

	Të pagueshme menjëherë	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti i pa-përcaktuar	Gjithsej
Aktivet financiare							
Aktive monetare dhe balancat me Bankën Qendrore	3,170,472	-	-	-	-	-	3,170,472
Balanca të kushtëzuara	-	-	-	-	-	3,268,442	3,268,442
Aktive financiare VDATGj	-	669,474	306,857	286,963	2,352,739	-	3,616,033
Aktive financiare me kosto të amortizuar		161,225	719,847	2,121,317	6,090,769	-	9,093,158
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	2,606,156	1,124,285	-	-	-	-	3,730,441
Hua dhe paradhënie klientëve	-	418,761	372,230	1,982,058	22,458,088	-	25,231,137
Gjithsej	**5,776,628**	**2,373,745**	**1,398,934**	**4,390,338**	**30,901,596**	**3,268,442**	**48,109,683**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj bankave	665,188	-	-	2,517,041	-	-	3,182,229
Detyrime ndaj klientëve	19,446,853	2,121,027	1,182,217	9,058,465	7,060,598	-	38,869,160
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	-	453,452	-	-	-	-	453,452
Borxhi i varur	-	-	-	-	1,133,621	-	1,133,621
Detyrimi për qiranë	-	5,074	10,182	44,515	741,968	-	801,739
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	418,160	418,160
Gjithsej	**20,112,041**	**2,579,553**	**1,192,399**	**11,620,021**	**8,936,187**	**418,160**	**44,858,361**
Hendeku i likuiditetit neto	**(14,335,413)**	**(205,808)**	**206,535**	**(7,229,683)**	**21,965,409**	**2,850,282**	**3,251,322**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

a) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Tabela e maturitetit më 31 dhjetor 2021

	Të pagueshme menjëherë	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	Maturiteti i pa-përcaktuar	Gjithsej
Aktivet financiare							
Aktive monetare dhe balancat me Bankën Qendrore	898,338	-	-	-	-	-	898,338
Balanca të kushtëzuara	-	-	-	-	-	2,713,545	2,713,545
Aktive financiare VDATGj	-	252,818	1,992,558	1,577,080	7,769,855	-	11,592,311
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	1,893,261	2,340,919	-	-	-	-	4,234,180
Hua dhe paradhënie klientëve	-	545,549	225,840	1,185,320	18,689,282	-	20,645,991
Gjithsej	**2,791,599**	**3,139,286**	**2,218,398**	**2,762,400**	**26,459,137**	**2,713,545**	**40,084,365**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj bankave	424,467	-	-	-	-	-	424,467
Detyrime ndaj klientëve	17,401,070	2,112,623	1,198,381	7,202,840	6,417,884	-	34,332,798
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	-	356,650	529,889	-	-	-	886,539
Borxhi i varur	-	-	-	2,368	591,724	-	594,092
Detyrimi për qiranë	-	5,386	10,746	47,956	838,602	-	902,690
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	134,659	134,659
Gjithsej	**17,825,537**	**2,474,659**	**1,739,016**	**7,253,164**	**7,848,210**	**134,659**	**37,275,245**
Hendeku i likuiditetit neto	**(15,033,938)**	**664,627**	**479,382**	**(4,490,764)**	**18,610,927**	**2,578,886**	**2,809,120**

Banka pret që flukset e pritshme nga aktivet financiare dhe detyrimet financiare të caktuara të ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga flukset e pritshme të kontraktuara të paraqitura si më sipër. Diferencat kryesore janë si më poshtë:

- 70% e balancave të kushtëzuara me Bankën Qendrore në Lekë janë në dispozicion të operacioneve ditore të Bankës dhe në rast të kundërt të përdoren për nevoja të likuiditetit të Bankës.
- Investimet të mbajtura për shitje kanë një maturim të mbetur nga 1 muaj deri në 14 vjet por menaxhimi mund të mos i mbaj deri në maturim.
- Një pjesë e madhe e llogarive rrjedhëse dhe të kursimit të klientëve janë riinvestuar përsëri pavarësisht se janë në kategorinë "Deri në 1 muaj".

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut

Rreziku i normës së interesit

Banka e vlerëson rrezikun e normës së interesit si rreziku që të ardhurat nga interesi i gjeneruar nga aktivet që mbartin interesa mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimeve të papritura të normave të interesit në treg. Veprimtaritë e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normës së interesit në atë nivel që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që paguajnë interes maturohen ose riçmohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e normave të ndryshueshme të aktiveve dhe detyrimeve, Banka është gjithashtu e ekspozuar ndaj rrezikut bazë, i cili është diferenca në karakteristikat e riçmimit të treguesve me norma të ndryshueshme, siç janë normat e Repove të Bankës së Shqipërisë, LIBOR dhe EURIBOR. Veç kësaj, efekti aktual varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë nivelin e shlyerjeve që bëhen më përpara ose më vonë sesa data e kontraktuar dhe ndryshimet në normat e interesave brenda periudhës së riçmimit dhe ndërmjet monedhave.

Në mënyrë që të masë rrezikun nga interesat të aktiviteteve jo-tregtare, Banka e mat impaktin që ka një ndryshim në normat e tregut në të ardhurat neto nga interesat.

Rreziku i normës së interesit në të ardhurat nga interesi neto i Bankës gjatë vitit të ardhshëm nga një ndryshim prej +100bp/-100bp më 31 dhjetor 2022 është +47/-47 milion (2021: ALL +11/-11 milion). Në tabelën e mëposhtme paraqitet një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje ose ulje në normat e interesit të tregut (duke supozuar që, nuk do të ketë lëvizje asimetrike në kurbat e kthimit dhe një pozicion konstant të bilancit) më 31 dhjetor 2022, gjithashtu paraqiten normat e interesit efektiv dhe periudhat në të cilat detyrimet dhe aktivet financiare riçmohen.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2022 normat efektive të interesit ishin:

	Gjithsej	Norma e int. efektiv	Instrumenta Me normë të ndryshueshme	Instrumenta me normë interesi fikse			
				<=1 muaj	1-3 muaj	3 muaj 1 vit	Më shumë se 1 vit
Aktivet financiare							
Aktivet monetare dhe balancat me Bankën Qendrore	3,170,472	-	-	3,170,472	-	-	-
Balanca të kushtëzuara	3,268,442	0.86%	-	3,268,442	-	-	-
Investime financiare të mbajtura me VDATGj	3,616,033	2.76%	-	669,474	306,857	286,963	2,352,739
Investime financiare me kosto të amortizuar	9,093,158	4.01%	-	161,225	719,847	2,121,317	6,090,769
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare dhe bankave	3,730,441	2.80%	2,156,677	1,573,764	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	25,231,137	7.57%	21,332,590	279,642	40,159	396,619	3,182,127
Gjithsej	**48,109,683**	**4.45%**	**23,489,267**	**9,123,019**	**1,066,863**	**2,804,899**	**11,625,635**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj bankave	3,182,229	1.27%	-	665,188	-	2,517,041	-
Detyrime ndaj klientëve	38,869,160	0.82%	-	21,567,880	1,182,217	9,058,465	7,060,598
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	453,452	2.60%	-	453,452	-	-	-
Borxhi i varur	1,133,621	3.96%	-	-	-	-	1,133,621
Detyrimi për qiranë	801,739	2.55%	-	5,074	10,182	44,515	741,968
Detyrime të tjera	418,160	0.00%	-	418,160	-	-	-
Gjithsej	**44,858,361**	**0.97%**	**-**	**23,109,754**	**1,192,399**	**11,620,021**	**8,936,187**
Rrçmimi / Hendeku i kohëzgjatjes	**3,251,322**	**3.48%**	**23,489,267**	**(13,986,735)**	**(125,536)**	**(8,815,122)**	**2,689,448**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normës së interesit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2021 normat efektive të interesit ishin si më poshtë:

	Gjithsej	Norma e int. efektiv	Instrumenta me normë të ndryshueshme	Instrumenta me normë interesi fikse <=1 muaj	1-3 muaj	3 muaj 1 vit	Më shumë se 1 vit
Aktivet financiare							
Aktivet monetare dhe balancat me Bankën Qendrore	898,338	-	-	898,338	-	-	-
Balanca të kushtëzuara	2,713,545	-0.19%	2,713,545	-	-	-	-
Investime financiare të mbajtura me VDATGj	11,592,311	3.48%	-	252,818	1,992,558	1,577,080	7,769,855
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare dhe bankave	4,234,180	0.05%	955,782	3,278,398	-	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	20,645,991	4.96%	17,349,264	259,087	12,865	304,872	2,719,903
Gjithsej	**40,084,365**	**3.56%**	**21,018,591**	**4,688,641**	**2,005,423**	**1,881,952**	**10,489,758**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj bankave	424,467	0.00%	-	424,467	-	-	-
Detyrime ndaj klientëve	34,332,798	0.86%	-	19,513,693	1,198,381	7,202,840	6,417,884
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	886,539	0.50%	-	356,650	529,889	-	-
Borxhi i varur	594,092	3.91%	-	-	-	2,368	591,724
Detyrimi për qiranë	902,690	2.55%	-	5,386	10,746	47,956	838,602
Detyrime të tjera	134,659	0.00%	-	134,659	-	-	-
Gjithsej	**37,275,245**	**0.92%**	**-**	**20,434,855**	**1,739,016**	**7,253,164**	**7,848,210**
Riçmimi / Hendeku i kohëzgjatjes	**2,809,120**	**2.63%**	**21,018,591**	**(15,746,214)**	**266,407**	**(5,371,212)**	**2,641,548**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i monedhës

Rreziku i monedhës është rreziku që ka të bëjë me luhatjen e vlerës së drejtë ose flukset e ardhshme të parasë së një instrument financiar nga ndryshimet në kurset e këmbimit. Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në monedhë të huaj dhe emërtimi i instrumentave financiarë në monedhë të huaj.

Nga ekspozimi i transaksioneve të Bankës lindin fitime ose humbje nga këmbimet në monedha të huaja të cilat njihen në humbje ose fitim. Këto ekspozime përfshijnë aktivet dhe detyrimet monetare të Bankës të cilat nuk janë në monedhën raportuese së Bankës.

Më 31 dhjetor 2022 ekspozimi ishte si më poshtë, (me të gjitha shumat në monedhë të huaj të përkthyera në Lekë):

	Lek	USD	EUR	Të tjera	Gjithsej
Aktivet financiare					
Mjete monetare dhe balancat me Bankën Qëndrore	1,570,630	138,425	1,405,052	56,365	**3,170,472**
Balanca të kushtëzuara	1,025,236	159,409	2,083,797	-	**3,268,442**
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj	2,070,458	403,130	1,142,445	-	**3,616,033**
Aktive financiare me kosto të amortizuar	8,135,422	-	957,736	-	**9,093,158**
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	910,136	400,689	2,366,139	53,477	**3,730,441**
Hua dhe paradhënie klientëve	9,269,874	249,916	15,711,295	52	**25,231,137**
Aktive të mbajtura për shitje	618,407	-	-	-	**618,407**
Gjithsej	**23,600,163**	**1,351,569**	**23,666,464**	**109,894**	**48,728,090**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave	665,177	8	2,517,044	-	**3,182,229**
Detyrime ndaj klientëve	18,397,009	1,316,195	19,046,705	109,251	**38,869,160**
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	453,452	-	-	-	**453,452**
Borxhi i varur			1,133,621		**1,133,621**
Detyrimi për qiranë	22,990	-	778,749	-	**801,739**
Detyrime të tjera	295,503	63,864	58,741	51	**418,159**
Gjithsej	**19,834,131**	**1,380,067**	**23,534,860**	**109,302**	**44,858,360**
Pozicioni neto i monedhës	**3,766,032**	**(28,498)**	**131,604**	**592**	**3,869,730**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

b) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i monedhës (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2021 ekspozimi ishte si më poshtë, (me të gjitha shumat në monedhë të huaj të përkthyera në Lekë):

	Lek	USD	EUR	Të tjera	Gjithsej
Aktivet financiare					
Mjete monetare dhe balancat me Bankën Qëndrore	335,708	122,101	407,561	32,968	**898,338**
Balanca të kushtëzuara	766,505	160,594	1,786,446	-	**2,713,545**
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj	9,311,903	-	2,280,408	-	**11,592,311**
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	2,220,158	787,087	1,177,041	49,894	**4,234,180**
Hua dhe paradhënie klientëve	8,005,834	336,964	12,303,143	50	**20,645,991**
Aktive të mbajtura për shitje	547,372	-	-	-	**547,372**
Gjithsej	**21,187,480**	**1,406,746**	**17,954,599**	**82,912**	**40,631,737**
Detyrimet financiare					
Detyrime ndaj bankave	424,459	7	1	-	**424,467**
Detyrime ndaj klientëve	16,461,776	1,395,635	16,395,622	79,765	**34,332,798**
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	886,539	-	-	-	**886,539**
Borxhi i varur			594,092		**594,092**
Detyrimi për qiranë	23,445	-	879,245	-	**902,690**
Detyrime të tjera	117,434	5,136	12,089	-	**134,659**
Gjithsej	**17,913,653**	**1,400,778**	**17,881,049**	**79,765**	**37,275,245**
Pozicioni neto i monedhës	**3,273,827**	**5,968**	**73,550**	**3,147**	**3,356,492**

Në lidhje me aktivet dhe detyrimet financiare monetare në monedhë të huaj të cilat nuk janë ekonomikisht të mbrojtura (hedged), Banka e menaxhon rrezikun nga monedhat e huaja në përputhje me politikat që vendosin kufizime në pozicionimin e monedhës dhe marrëveshjeve.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë

Banka është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet aktivitetit huadhënës dhe në ato raste kur ajo vepron si ndërmjetëse për llogari të klientëve të saj ose palëve të treta ose kur jep garanci. Në lidhje me këtë, rreziku i kredisë për Bankën lind nga mundësia që palë të ndryshme mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë paguese të huamarrësve dhe përcaktimit të një note klasifikuese. Gjithashtu ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet pjesërisht duke marrë kolaterale dhe garanci.

SNRF 9 përshkruan një model me 'tre nivele' për zhvlerësim bazuar në ndryshimet në cilësinë e kredisë që nga njohja fillestare. Instrumentet financiare në Nivelin 1 kanë HPK të matur në një shumë të barabartë me pjesën e humbjeve të pritshme që rezultojnë nga ngjarjet e mospagesës së detyrimeve të mundshme brenda 12 muajve të ardhshëm. Instrumentet në Nivelet 2 ose 3 i kanë HPK-të të matur në bazë të humbjeve të pritura gjatë gjithë afatit të jetës së tyre.

Sipas metodologjisë së Bankës, të gjitha ekspozimet klasifikohen si ekspozime pa probleme (përfshirë Nivelin 1 dhe Nivelin 2) dhe ekspozimet me probleme (Niveli 3).

Tabela në vijim përmbledh kriteret që Fibank ka miratuar për ndarjen e huave ne nivele:

Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
▫ Ekspozime pa probleme deri në 30 ditë vonesë	▫ Ekspozime pa probleme mbi 30 ditë të vonesë ▫ Ekspozime forborne me vonesa deri në 30 ditë	▫ Ekspozime të klasifikuara me probleme sipas rregulloreve të Bankës së Shqipërisë. ▫ Ekspozime forborne me vonesa mbi 30 ditë

Aplikimi i secilit kriter është përshkruar më poshtë:

- Niveli 1 përfshin ekspozimet pa probleme për të cilët nuk plotësohen asnjë nga kriteret e Nivelit 2 dhe 3.
- Treguesit e rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë që klasifikojnë një hua në Nivelin 2 janë si më poshtë:
  - Kundërpartitë janë në një situatë prej më shumë se 30 ditë vonesa.
  - Statusi 'i ristrukturuar' në 12 muajt e fundit për ekspozimet pa probleme. Vonesat / ristrukturimi identifikohet si një tjetër kriter i përkeqësimit të kredisë pasi paraqet rrezikun e lëshimit të bërë ndaj një klienti që përballet ose do të përballet me vështirësi në përmbushjen e angazhimeve financiare.
- Treguesit e rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë që klasifikojnë një hua në Nivelin 3 janë si më poshtë:
  - Kundërpartitë e klasifikuara si nën standarte (më shumë se 90 ditë vonesë) ose më keq sipas Rregullores së Bankës së Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut të kredisë"
  - Ekspozimet pa probleme të ristrukturuara, që janë ristrukturuar në 12 muajt e fundit që janë më shumë se 30 ditë në vonesë në datën e raportimit.
  - Debitori konsiderohet se s'do mund të paguajë sepse Banka ka informacion mbi (i) vështirësi të mëdha financiare, (ii) veprime ligjore të filluara për huamarrësin nga autoritetet shtetërore etj. (iii) zhdukjen e një tregu aktiv ku huamarrësi kishte një pjesë të tregut për shkak të vështirësive financiare.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas klasave të aktiveve financiare

Tabela në vijim paraqet informacion në lidhje me cilësinë e kredisë dhe paradhënieve të matura me koston e amortizuar dhe aktiveve financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për dhjetor 2022. Përveç nëse tregohet në mënyrë specifike, për aktivet financiare, shumat në tabelë përfaqësojnë vlerën e mbartur bruto.

	31 dhjetor 2022			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Hua dhe paradhënie klientëve				
-Pa probleme (Performuese)	23,646,786	844,883	-	**24,491,669**
-Në vonesë	-	-	821,917	**821,917**
-Me mundësi mospagimi	-	-	311,066	**311,066**
-Të dyshimta	-	-	589,078	**589,078**
Gjithsej	**23,646,786**	**844,883**	**1,722,061**	**26,213,730**
Zhvlerësimi	**(388,086)**	**(131,577)**	**(462,930)**	**(982,593)**
Vlera neto	**23,258,700**	**713,306**	**1,259,131**	**25,231,137**
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj				
-Pa probleme	3,616,033	-	-	**3,616,033**
Gjithsej	**3,616,033**	**-**	**-**	**3,616,033**
Vlera neto	**3,616,033**	**-**	**-**	**3,616,033**
Zhvlerësimi	**(10,248)**			**(10,248)**
Aktie financiare te mbajtura me kosto te amortizuar				
-Pa probleme (Performuese)	9,104,223	-	-	**9,104,223**
Gjithsej	**9,104,223**			**9,104,223**
Zhvlerësimi	**(11,065)**			**(11,065)**
Vlera neto	**9,093,158**			**9,093,158**

Zhvlerësimi për letrat me vlerë të investimit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe jo si kundërvlerë ndaj vlerës kontabël të aktivit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar (shih Shënimin 3 (f) (viii).

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas klasave të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet informacion në lidhje me cilësinë e kredisë dhe paradhënieve të matura mbi koston e amortizuar, me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për dhjetor 2021.

	31 dhjetor 2021			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Hua dhe paradhënie klientëve				
-Pa probleme (Performuese)	18,454,849	1,329,485	-	**19,784,334**
-Në vonesë	-	-	967,040	**967,040**
-Me mundësi mospagimi	-	-	197,034	**197,034**
-Të dyshimta	-	-	642,789	**642,789**
Gjithsej	**18,454,849**	**1,329,485**	**1,806,863**	**21,591,197**
Humbjet nga zhvlerësimi	**(217,468)**	**(208,829)**	**(518,909)**	**(945,206)**
Vlera neto	**18,237,381**	**1,120,656**	**1,287,954**	**20,645,991**
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj				
-Pa probleme	11,592,311	-	-	**11,592,311**
Gjithsej	**11,592,311**	**-**	**-**	**11,592,311**
Vlera neto	**11,592,311**	**-**	**-**	**11,592,311**
Humbjet nga zhvlerësimi	**(21,853)**	**-**	**-**	**(21,853)**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas klasave të aktiveve financiare (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet informacionin për statusin në vonesë të huave dhe paradhënieve për klientët në Nivelet 1, 2 dhe 3.

Sipas ditë vonesave më 31 dhjetor 2022.

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Shuma bruto				
-Pa vonesë	20,190,631	75,163	-	20,265,794
-Në vonesë nën 30 ditë	3,456,155	28,587	375,146	3,859,888
-Në vonesë mbi 30 ditë	-	741,133	1,346,915	2,088,048
Gjithsej	**23,646,786**	**844,883**	**1,722,061**	**26,213,730**

Më 31 dhjetor 2021:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Shuma bruto				
-Pa vonesë	16,245,616	145,741	-	16,391,357
-Në vonesë nën 30 ditë	2,162,525	308,148	245,579	2,716,252
-Në vonesë mbi 30 ditë	46,708	875,596	1,561,284	2,483,588
Gjithsej	**18,454,849**	**1,329,485**	**1,806,863**	**21,591,197**

Shumat që rezultojnë nga HPK-të

Të dhënat, supozimet dhe teknikat e përdorura për përlogaritjen e zhvlerësimit

Shih politikën e kontabilitetit në Shënimin 3 (f) (viii).

Banka ka respektuar "Rregulloren për matjen e humbjes së pritshme të kredisë në zbatim të standardit SNRF 9 (Politika e Zhvlerësimit)" të miratuar nga Këshilli Drejtues, e cila përcakton rregullat metodologjike të adoptuara për përcaktimin e nivelit dhe për llogaritjen e Humbjes së Pritshme të Kredisë për aktivet financiare përfshirë në kategoritë e mëposhtme të kontabilitetit: Kosto e amortizuar ("KA") dhe Vlera e Drejtë nëpërmjet të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse ("VDATGj") sipas standardit SNRF 9. Portofoli pa probleme ndahet në dy nivele të veçanta (Niveli 1 ku llogariten humbjet e pritshme 12 mujore dhe Niveli 2 ku llogariten humbjet e pritshme përgjatë gjithë jetës) dhe përfshihen parashikimet për kushtet e ardhshme në vlerësimin e humbjes së pritshme. Për kategorinë e huave me probleme (Niveli 3 sipas standardit SNRF 9) është parashikuar një shtojcë gjatë llogaritjes së humbjes së pritshme për të përfshirë parashikimet për kushtet e ardhshme. Vlerësimet për zhvlerësimin kryhen në përputhje me Metodologjinë e zhvlerësimit për matjen e humbjes së pritshme të kredisë në zbatim të standardit SNRF 9 (Politika e Zhvlerësimit) sipas të cilës kategoria e huave pa probleme është subjekt i zhvlerësimit kolektiv, ndërsa tre kategoritë e tjera (me probleme) mund të jetë subjekt zhvlerësimit individual ose kolektiv.

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

Rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë

Gjatë përcaktimit nëse rreziku i mospagesës së një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare, Banka vlerëson informacione të arsyeshme dhe të besueshme që janë të përshtatshme dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Kjo përfshin informacione dhe analiza sasiore dhe cilësore, bazuar në përvojën historike të Bankës dhe vlerësimin profesional të kredisë dhe duke përfshirë parashikimet për kushtet e ardhshme. Qëllimi i vlerësimit është të identifikojë nëse për një ekspozim të caktuar ka ndodhur ndonjë rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë për një ekspozim.

Në përgjithësi, ka një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë para se një aktiv financiar të zhvlerësohet ose që të ndodhë një mospërmbushje detyrimi: ky fakt i thjeshtë është vendimtar për qëllimin e SNRF 9-s, i cili synon njohjen e humbjeve të pritshme në kohën e duhur.

Së bashku me treguesit "sasiorë" për të përcaktuar rritjen e rrezikut të kredisë, përdoren një numër treguesish "cilësorë". Vetë SNRF9 specifikon një listë jo-shteruese të këtyre treguesve; mes të cilëve:

- një ndryshim të rëndësishëm aktual ose të pritshëm në rezultatet e operimit të huamarrësit;
- vendimet nga Banka që rreziku i kredisë për atë instrument është dukshëm më i lartë ose që kolateral dhe/ose garantor shtesë duhet të kërkohet, ne krahasim me momentin kur ai instrument i caktuar u njoh.
- ndryshime të rëndësishme, të tilla si zvogëlimi i mbështetjes financiare nga një njësi ekonomike mëmë ose degë tjetër ose një ndryshim i rëndësishëm aktual ose i pritshëm në garancitë e kredisë, të cilat priten të zvogëlojnë aftësinë ekonomike të huamarrësit për të bërë pagesa kontraktuale të planifikuara;
- ndryshimet e pritura në dokumentacionin e huasë duke përfshirë një prishje të pritshme të kontratës që mund të çojë në heqjen e garancive ose amendamenteve, stopimin e pagesave të interesit, ngritjen e normave të interesit, kërkimin e kolateraleve ose garancive shtesë, ose ndryshime të tjera në kuadrin kontraktual të instrumentit;
- ndryshime në qasjen e menaxhimit të kredisë nga Banka në lidhje me instrumentin financiar.

Në praktikë, treguesit cilësorë dhe sasiorë mund të përdoren së bashku.

Përkufizimi i mospërmbushjes së detyrimeve

Përsa i përket Nivelit 3, SNRF 9 specifikon se kur përcaktohet mospërmbushja e detyrimit për qëllimet e përcaktimit të rrezikut të ndodhjes së një mospërmbushje, Banka do të zbatojë një përkufizim që është në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime të drejtimit të rrezikut të brendshëm të kredisë për instrumentin financiar përkatës dhe merr në konsideratë treguesit cilësorë (për shembull, lidhjet financiare) kur është e përshtatshme. Megjithatë, është supozuar që është e vërtetë se mospërmbushja e detyrimit nuk ndodh më vonë se kur një aktiv financiar është 90 ditë në vonesë, përveç nëse Banka ka informacione të arsyeshme dhe të mbështetshme për të demonstruar se një kriter për mospërmbushjen më i lartë është më i përshtatshëm. Në çdo rast, udhëzimet nga autoritetet kompetente specifikojnë që institucionet duhet të udhëhiqen nga përkufizimi i përdorur për qëllime rregullative të parashikuara në nenin 178 të Rregullores (BE) 575/2013 (Rregullorja e Kërkesës së Kapitalit CRR).

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

Humbjet e pritshme të kredisë

SNRF 9 (Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar) - Instrumentet Financiare, bazohet në vlerësimin e humbjeve të pritshme. Në momentin e njohjes së përkeqësimit të konsiderueshëm të cilësisë së kredisë, prezantohet koncepti i ri i humbjes përgjatë gjithë jetës. HPK përgjatë gjithë jetës mbulon të gjithë humbjen e pritshme sipas SNRF 9, i cili specifikon se nëse rreziku i kredisë për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare, subjekti duhet të masë zbritjen për zhvlerësimin për instrument financiar përkatës si një shumë e barabartë me HPK përgjatë gjithë jetës dhe nëse rreziku i kredisë për këtë instrument nuk është rritur ndjeshëm, atëherë duhet të llogarisë HPK për 12 muaj.

Për ekspozimevet pa probleme pa një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që janë klasifikuar në fazën 1, në origjinën e secilit instrument financiar jo të dëmtuar, njihen humbjet e pritshme të kredisë 12-mujore. HPK-të për ekspozimet në nivelin e parë llogariten duke shumëzuar probabilitetin e mospagesës (PD) 12 mujor me humbjen në rast mospagese (LGD) dhe ekspozimin në rast mospagese (EAD).

HPK përgjatë gjithë jetës llogaritet duke shumëzuar probabilitetin e mospagesës gjatë gjithë jetëgjatësisë me humbjen në rast mospagese dhe ekspozimin në rast mospagese. Banka përdor modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të probabilitetit të mospagesës të pjesës së mbetur të jetëgjatësisë të ekspozimeve dhe se si këto priten të ndryshojnë me kalimin e kohës. Banka mbledh informacione mbi ecurinë dhe mospërmbushjen e detyrimeve për ekspozimet e saj ndaj rrezikut të kredisë të cilat analizohen sipas llojit të produktit dhe huamarrësit si dhe sipas klasifikimit të rrezikut të kredisë.

Humbja në rast mospagese (LGD) është shuma e humbjes së mundshme në rastin e mospagesës. Banka vlerëson parametrat e humbjes në rast mospagese (LGD) në bazë të historikut të normave të humbjes nga palët që nuk kanë përmbushur kushtet e pagesës. Modelet e humbjes në rast mospagese (LGD) vlerësojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës, industrinë dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivit financiar. Vlerësimet e humbjes në rast mospagese (LGD) llogariten në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara nëpëmjet normës efektive të interesit.

EAD është një vlerësim i ekspozimit total në datën e raportimit, duke marrë parasysh ndryshimet e pritshme në ekspozimin pas datës së raportimit, duke përfshirë tërheqjet e pritura në objektet e zotuara. Faktori i konvertimit të kredisë përdoret për të konvertuar shumën e një linje kredie (pjesa e papërdorur) dhe shumat e tjera jashtë bilancit në shumën e EAD. Është një supozim i modeluar, i cili përfaqëson një pjesë të çdo ekspozimi të patërhequr që pritet të tërhiqet përpara ngjarja e mospërmbushjes së detyrimit të ndodhë. Për çdo lloj produkti, faktori i kovertimit të kredisë që aplikon Banka është si më poshtë:

Pjesa e pashfrytëzuar e Huave me Afat = 0%

Pjesa e papërdorur e Overdrafteve = 100%

Pjesa e papërdorur e Kartave të Kreditit = 100%

Pjesa e papërdorur e Kartave të Kreditit të klasifikuara si "të bllokuara", "të mbyllura" ose "Gri" = 0%

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

Tabelat në vijim tregojnë rikonsilimin nga hapja deri në bilancin mbyllës të humbjeve për huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve.

	2022			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Shuma bruto				
Gjëndja 1 Janar	18,454,849	1,329,485	1,806,863	**21,591,197**
-Transferuar ne Nivelin 1	338,326	(267,629)	(70,697)	-
-Transferuar në Nivelin 2	(620,604)	650,687	(30,083)	-
-Transferuar në Nivelin 3	(132,153)	(209,658)	341,811	-
-Rimarrja neto	(2,302,154)	(131,170)	(94,592)	**(2,527,916)**
-Kreditë e reja	9,548,476	169,762	28,516	**9,746,754**
-Fshirjet	-	-	(233,058)	**(233,058)**
-Lëvizje të tjera	(1,639,954)	(696,594)	(26,699)	**(2,363,247)**
Gjëndja 31 dhjetor	**23,646,786**	**844,883**	**1,722,061**	**26,213,730**
Humbjet nga zhvlerësimi				
Gjëndja 1 Janar	217,468	208,829	518,909	**945,206**
-Transferuar ne Nivelin 1	50,968	(46,251)	(4,717)	-
-Transferuar në Nivelin 2	(6,994)	27,160	(20,166)	-
-Transferuar në Nivelin 3	(1,660)	(25,320)	26,980	-
-Rimarrja neto	(13,845)	64,282	53,449	**103,886**
-Kreditë e reja	163,538	21,159	13,995	**198,692**
-Fshirjet	-	-	(111,010)	**(111,010)**
-Lëvizje të tjera	(21,389)	(118,282)	(14,510)	**(154,181)**
Gjëndja 31 dhjetor	**388,086**	**131,577**	**462,930**	**982,593**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

	2021			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Hua dhe paradhënie klientëve				
Gjëndja 1 Janar	15,488,064	1,108,944	1,311,210	**17,908,218**
-Transferuar ne Nivelin 1	225,402	(168,324)	(57,078)	-
-Transferuar në Nivelin 2	(828,013)	832,885	(4,872)	-
-Transferuar në Nivelin 3	(427,732)	(251,077)	678,809	-
-Rimarrja neto	(1,875,627)	(86,853)	(25,540)	**(1,988,020)**
-Kreditë e reja	7,973,075	158,562	34,130	**8,165,767**
-Fshirjet	-	-	(44,481)	**(44,481)**
-Lëvizje të tjera	(2,100,320)	(264,652)	(85,315)	**(2,450,287)**
Gjëndja 31 dhjetor	**18,454,849**	**1,329,485**	**1,806,863**	**21,591,197**
Hua dhe paradhënie klientëve				
Gjëndja 1 Janar	177,611	202,335	430,131	**810,077**
-Transferuar ne Nivelin 1	32,496	(25,508)	(6,988)	-
-Transferuar në Nivelin 2	(7,672)	9,148	(1,476)	-
-Transferuar në Nivelin 3	(4,469)	(39,339)	43,808	-
-Rimarrja neto	(48,765)	64,578	76,471	**92,284**
-Kreditë e reja	92,940	43,949	28,244	**165,133**
-Fshirjet	-	-	(19,495)	**(19,495)**
-Lëvizje të tjera	(24,673)	(46,334)	(31,786)	**(102,793)**
Gjëndja 31 dhjetor	**217,468**	**208,829**	**518,909**	**945,206**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

Ekspozimet sipas kategorisë së rrezikut më 31 dhjetor 2022 ishin si më poshtë:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Ekspozimi bruto				
-Standarte	23,587,537	508,161	10	**24,095,708**
-Në ndjekje	59,249	336,722	109,181	**505,152**
-Nën standarte	-	-	712,726	**712,726**
-Të dyshimta	-	-	311,066	**311,066**
-Të humbura	-	-	589,078	**589,078**
Gjithsej	**23,646,786**	**844,883**	**1,722,061**	**26,213,730**
Humbjet nga zhvlerësimi				
-Standarte	(387,083)	(87,196)	(10)	**(474,289)**
-Në ndjekje	(1,003)	(44,381)	(28,344)	**(73,728)**
-Nën standarte	-	-	(65,973)	**(65,973)**
-Të dyshimta	-	-	(19,291)	**(19,291)**
-Të humbura	-	-	(349,312)	**(349,312)**
Gjithsej	**(388,086)**	**(131,577)**	**(462,930)**	**(982,593)**
Ekspozimi neto				
-Standarte	23,200,454	420,965	-	**23,621,419**
-Në ndjekje	58,246	292,341	80,837	**431,424**
-Nën standarte	-	-	646,753	**646,753**
-Të dyshimta	-	-	291,775	**291,775**
-Të humbura	-	-	239,766	**239,766**
Gjithsej	**23,258,700**	**713,306**	**1,259,131**	**25,231,137**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Shumat që rezultojnë nga HPK-të (vazhdim)

Ekspozimet sipas kategorisë së rrezikut më 31 dhjetor 2021 ishin si më poshtë:

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Ekspozimi bruto				
-Standarte	18,393,013	556,099	115	**18,949,227**
-Në ndjekje	61,836	773,386	159,789	**995,011**
-Nën standarte	-	-	807,136	**807,136**
-Të dyshimta	-	-	197,034	**197,034**
-Të humbura	-	-	642,789	**642,789**
Gjithsej	**18,454,849**	**1,329,485**	**1,806,863**	**21,591,197**
Humbjet nga zhvlerësimi				
-Standarte	(216,736)	(78,176)	(95)	**(295,007)**
-Në ndjekje	(732)	(130,653)	(5,621)	**(137,006)**
-Nën standarte	-	-	(69,678)	**(69,678)**
-Të dyshimta	-	-	(48,887)	**(48,887)**
-Të humbura	-	-	(394,628)	**(394,628)**
Gjithsej	**(217,468)**	**(208,829)**	**(518,909)**	**(945,206)**
Ekspozimi neto				
-Standarte	18,176,277	477,923	20	**18,654,220**
-Në ndjekje	61,104	642,733	154,168	**858,005**
-Nën standarte	-	-	737,458	**737,458**
-Të dyshimta	-	-	148,147	**148,147**
-Të humbura	-	-	248,161	**248,161**
Gjithsej	**18,237,381**	**1,120,656**	**1,287,954**	**20,645,991**

Veç kësaj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për zërat jashtë bilanci nëpërmjet angazhimeve deri në nivelin e kredive dhe garancive të dhëna (shiko shënimi 31.

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë (brenda ose jashtë zërave të bilancit) që lind nga instrumentat financiarë ekziston për palë të tjera kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat mund të bëjnë që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet njësoj nga ndryshime në kushtet ekonomike ose faktorë të tjerë. Përqëndrimi kryesor i rrezikut të kredisë lind nga lloje të ndryshme klientësh dhe vendodhja e tyre në lidhje me investimet e Bankës, huatë dhe paradhëniet, detyrimet e ardhshme të angazhimeve në nivelin e kredisë dhe garancive të dhëna.

Politika e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat një hua (dhe zbritjet përkatëse për humbje nga zhvlerësim) kur Këshilli Drejtues i Bankës përcakton se kredia është e paarkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacionit për ndodhjen e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë të tillë që huamarrësi nuk paguan dot më detyrimet ose kolaterali nuk do të jetë i mjaftueshëm për të shlyer të gjithë ekspozimin dhe huaja klasifikohet në kategorinë e huave të humbura për arsye të raportimit rregullator për një periudhë prej të paktën 3 vjet. Politika e Bankës është gjithashtu në përputhje me Rregulloren e ndryshuar nr. 62, datë 14/09/2011 "Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë për Bankat dhe Degët e Bankave të Huaja".

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Një analizë e përqëndrimit të rrezikut të kredisë sipas sektorëve ekonomikë dhe fondi respektiv për humbjet nga kreditë është paraqitur në tabelën më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Tregti	4,231,113	4,027,570
Individë	11,831,744	9,259,805
Komunikim	106,451	156,065
Ndërtim	3,086,361	1,891,929
Turizëm	1,460,286	1,686,174
Bujqësi	105,385	311,064
Transport	445,107	568,047
Industri	2,326,037	1,748,902
Shërbime	1,991,589	1,473,664
Financë	629,657	467,977
Rreziku i kredisë bruto	**26,213,730**	**21,591,197**
Tregti	(182,764)	(160,515)
Individë	(435,923)	(397,775)
Komunikim	(4,834)	(2,268)
Ndërtim	(122,787)	(84,932)
Turizëm	(59,808)	(128,684)
Bujqësi	(3,533)	(47,511)
Transport	(9,111)	(6,480)
Industri	(81,783)	(61,265)
Shërbim	(66,278)	(50,159)
Financë	(15,772)	(5,617)
Minus fondin për zhvlerësimet	**(982,593)**	**(945,206)**
Rreziku i kredisë neto	**25,231,137**	**20,645,991**

Shuma e paraqitur në tabelë paraqet maksimumin e humbjes kontabël që mund të njihet në datën e raportimit nëse pala tjetër dështon plotësisht të përmbushi detyrimet e saj sipas termave të kontratës dhe kolaterali ose siguria e marrë nga klientët të mos kenë vlerë. Kështu që shumat janë shumë më të mëdha se sa humbjet e pritshme, të cilat janë të përfshira në fondin për humbje nga kreditë.

Politika e Bankës është që të kërkojë kolateral të përshtatshëm nga klientët përpara lëvrimit të kredisë. Garancitë dhe letrat e kreditit janë gjithashtu subjekt i një vlerësimi strikt pëpara se të aprovohen. Marrëveshjet specifikojnë limite monetare të detyrimeve të Bankës. Niveli i kolateralit i mbajtur për garancitë dhe letrat e kreditit është të paktën 100 përqind.

Kolaterali për kreditë, garancitë dhe letrat e kreditit është zakonisht në formë monetare, inventar hipotekor, investime të regjistruara ose pasuri të tjera.

4. Paraqitja e Menaxhimi të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Kolateralet në zotërim dhe garanci të tjera të kredisë

Flukset monetare të parashikuara që rrjedhin nga kolaterali, duke përfshirë garancitë për sigurimin e ekspozimeve, zakonisht janë burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorur për llogaritjen janë:

- Vlera e realizueshme e kolateraleve, e cila përcaktohet duke zvogëluar vlerën e vlerësuar të tregut të kolateralit me një faktor skontimi. Ky vlerësim merr parasysh karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve. Ai supozon një vlerë mesatare të rikuperueshme të kolateralit specifik, bazuar në përvojën e Bankës.
- Afati i rrjedhës së pritshme të parasë, që paraqet kohën e pritshme të rimëkëmbjes (në vite) për një lloj të veçantë të kolateralit.

Në përgjithësi, kolaterali nuk mbahet mbi huatë dhe paradhëniet ndaj institucioneve financiare, përveçse kur letrat me vlerë mbahen si pjesë e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes dhe aktivitetit të huamarrjes së letrave me vlerë. Zakonisht, kolaterali nuk mbahet kundrejt letrave me vlerë të investimit, dhe asnjë kolateral i tillë nuk është mbajtur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përditësohen çdo një deri në tre vjet.

Tabela më poshtë paraqet një detajim të totalit të kredive dhënë klientëve bazuar në llojin e kolateralit dhe fondin për humbje nga kreditë,sipas llojit të kolateralit, deri në maksimumin e detyrimit të papaguar:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Depozita bankare	2,039,253	1,071,677
Hipotekë	18,883,245	16,729,387
Garanci	102,109	179,412
Barrë siguruese-makineri	973,346	807,452
Barrë siguruese-të arkëtueshme	288,110	226,811
Kolaterale të tjera	3,927,667	2,576,458
Rreziku i kredisë bruto	**26,213,730**	**21,591,197**
Depozita bankare	(46,923)	(34,189)
Hipotekë	(400,272)	(481,068)
Garanci	(2,417)	(3,387)
Barrë siguruese-makineri	(63,754)	(69,992)
Barrë siguruese-të arkëtueshme	(40,999)	(31,365)
Kolaterale të tjera	(428,228)	(325,205)
Fondi rezervë për humbje nga zhvleresimi	**(982,593)**	**(945,206)**
Rreziku i kredisë neto	**25,231,137**	**20,645,991**

4. Paraqitja e Menaxhimi të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Ekspozimi maksimal i kredisë

Tabela më poshtë paraqet ekpozimin maksimal të kredis për zërat e bilancit dhe zërat jashtë bilanci në 31 dhjetor 2022.

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Mjete monetare dhe balancat me Bankën Qëndrore	3,170,472	898,338
Balanca të kushtëzuara	3,268,442	2,713,545
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj	3,616,033	11,592,311
Aktive financiare me kosto të amortizuar	9,093,158	-
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	3,730,441	4,234,180
Hua dhe paradhënie klientëve`	25,231,137	20,645,991
Rreziku i kredisë për zërat e bilancit	**48,109,683**	**40,084,365**
Angazhime dhënë klientëve	1,228,474	818,779
Garanci bankare	272,803	174,270
Rreziku i kredisë për zërat jashtë bilanci	**1,501,277**	**993,049**
Ekspozimi maksimal i kredisë	**49,610,960**	**41,077,414**

Kur aktivet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e paraqitura përfaqësojnë ekspozimin aktual të rrezikut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal ndaj rrezikut që mund të lindë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve në vlerën e drejtë. Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund të kërkojnë që Banka të kryejë pagesa në emër të tyre dhe të marrë angazhime për të zgjeruar linjat e kreditit për të siguruar nevojat e tyre për likuiditet. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten nga të njëjtat procese dhe politika kontrolli. Çdo muaj, Banka vlerëson angazhimet lidhur me kredinë për zhvlerësim. Shumat që i nënshtrohen vlerësimit individual të zhvlerësimit janë angazhime të pa anulueshme të dhëna klientëve me probleme ose klientëve me lehtësi krediti të ristrukturuara.

4. Paraqitja e Menaxhimi të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Tabelat më poshtë paraqesin një detajim të ekspozimeve forborne në 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

31 dhjetor 2022

		Hua të rregullta			Hua me probleme				
Hua dhe paradhënie për klientët	**Vlera kontabël bruto**	**Modifikimi i kushteve kontraktuale**	**Rifinancimi**	**Hua të rregullta forborne gjithsej**	**Modifikimi i kushteve kontraktuale**	**Rifinancimi**	**Hua me probleme forborne gjithsej**	**Hua forborne gjithsej**	**Raporti forborne/ Hua bruto**
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	14,299,369	2,425,769	173,574	2,599,343	35,649	722,066	757,715	3,357,058	23.48%
Hua konsumatore	2,725,363	56,648	32,109	88,757	10,127	18,994	29,121	117,878	4.33%
Hua hipotekore	9,188,999	1,200,836	158,906	1,359,742	27,933	158,421	186,354	1,546,096	16.83%
Gjithsej	**26,213,731**	**3,683,253**	**364,589**	**4,047,842**	**73,709**	**899,481**	**973,190**	**5,021,032**	**19.15%**

31 dhjetor 2021

		Hua të rregullta			Hua me probleme				
Hua dhe paradhënie për klientët	**Vlera kontabël bruto**	**Modifikimi i kushteve kontraktuale**	**Rifinancimi**	**Hua të rregullta forborne gjithsej**	**Modifikimi i kushteve kontraktuale**	**Rifinancimi**	**Hua me probleme forborne gjithsej**	**Hua forborne gjithsej**	**Raporti forborne/ Hua bruto**
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	12,237,486	3,080,380	366,116	3,446,496	15,965	837,228	853,193	4,299,689	35.1%
Hua konsumatore	1,971,585	115,920	37,288	153,208	9,330	36,112	45,442	198,650	10.1%
Hua hipotekore	7,382,127	1,440,873	197,038	1,637,911	68,915	159,745	228,660	1,866,571	25.3%
Gjithsej	**21,591,198**	**4,637,173**	**600,442**	**5,237,615**	**94,210**	**1,033,085**	**1,127,295**	**6,364,910**	**29.5%**

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

	31 dhjetor 2022							
	Vlera bruto e huave forborne				HPK			
Hua dhe paradhënie për klientët	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Gjithsej**	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Gjithsej**
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	2,442,520	156,823	757,715	3,357,058	(50,143)	(21,433)	(99,505)	(171,081)
Hua konsumatore	60,725	28,032	29,121	117,878	(1,021)	(1,557)	(18,555)	(21,133)
Hua hipotekore	1,231,736	128,006	186,354	1,546,096	(9,670)	(13,125)	(19,524)	(42,319)
Gjithsej	**3,734,981**	**312,861**	**973,190**	**5,021,032**	**(60,834)**	**(36,115)**	**(137,584)**	**(234,533)**

	31 dhjetor 2021							
	Vlera bruto e huave forborne				HPK			
Hua dhe paradhënie për klientët	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Gjithsej**	**Niveli 1**	**Niveli 2**	**Niveli 3**	**Gjithsej**
Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	2,616,725	829,771	853,193	4,299,689	(29,160)	(159,406)	(140,928)	(329,494)
Hua konsumatore	118,654	34,554	45,442	198,650	(2,055)	(3,255)	(27,767)	(33,077)
Hua hipotekore	1,496,146	141,764	228,660	1,866,570	(14,989)	(7,798)	(14,604)	(37,391)
Gjithsej	**4,231,525**	**1,006,089**	**1,127,295**	**6,364,909**	**(46,204)**	**(170,459)**	**(183,299)**	**(399,962)**

4. Paraqitja e Menaxhimi të Rrezikut (vazhdim)

c) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Banka gjatë vitit 2021 (deri më 30 qershor 2021) është inkurajuar, rekomanduar dhe kërkuar nga qeveria dhe rregullatorët për të ofruar hua të reja për klientët nën 2-lloje të Huasë Sovrane të qeverisë:

1- Pagesa e pagave në kuadër të programit Covid-19

2- Huatë Sovrane në kuadër të programit Covid-19, për zhvillimin e biznesit ("Kapitali Punues")

Tabela më poshtë paraqet numrin e klientëve dhe vlerat përkatëse të ekspozimeve nën programin e mbështetjes qeveritare në 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

31 dhjetor 2022				
	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Hua konsumatore	Hua hipotekore	Gjithsej
Numri i aplikimeve pezull	-	-	-	-
Numri i aplikimeve të miraturara	30	-	-	30
Vlera e huave nën programin e mbështetjes qeveritare	570,210	-	-	570,210
% e portofolit	4.1%	0.0%	0.0%	2.3%

31 dhjetor 2021				
	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme	Hua konsumatore	Hua hipotekore	Gjithsej
Numri i aplikimeve pezull	-	-	-	-
Numri i aplikimeve të miraturara	48	-	-	48
Vlera e huave nën programin e mbështetjes qeveritare	868,570	-	-	868,570
% e portofolit	7.4%	0.0%	0.0%	7.4%

Tabela më poshtë paraqet vlerën bruto dhe humbjet e pritshme të kredisë përkatëse sipas nivele për huatë dhe paradhëniet për klientët që kanë pasur lehtësime për shkak të programit mbështetës të qeverisë në 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

31 dhjetor 2022				
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Vlera bruto e huave	471,222	59,595	49,014	579,831
% e portofolit	1.99%	7.05%	2.85%	2.21%
HPK	(9,621)	-	-	(9,621)
% e HPK	2.5%	0.0%	0.0%	1.0%

31 dhjetor 2021				
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Gjithsej
Vlera bruto e huave	731,670	144,987	-	876,657
% e portofolit	4.0%	10.9%	0.0%	4.1%
HPK	(8,087)	-	-	(8,087)
% e HPK	3.7%	0.0%	0.0%	0.9%

4. Paraqitja e Menaxhimit të Rrezikut (vazhdim)

d) Administrimi i kapitalit

Kapitali rregullator

Rregullatori i Bankës, Banka e Shqipërisë, vendos dhe monitoron kërkesat në lidhje me kapitalin rregullator. Në implementimin e kërkesave aktuale për kapitalin rregullator, Banka është e detyruar të mbajë në jo më pak se 12% raportin e totalit të kapitalit mbi aktivet e ponderuara me normat rrezikut. Normat e rrezikut të përdorura për ponderimin e aktiveve përcaktohen në përputhje me kërkesat specifike të cilat kanë për qëllim të reflektojnë nivelet e ndryshme të rrezikut që mbartin aktivet dhe zërat jashtë bilancit.

Banka i llogarit kërkesat për ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke u bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi mjaftueshmerine e kapitalit. Ekspozimet merren në konsideratë duke përdorur shumat e tyre në datën e bilancit. Zërat jashtë bilancit të lidhura me angazhimet llogariten duke aplikuar kategori të ndryshme të faktorëve të konvertimit, të dizenjuara për të konvertuar këto zëra në ekuivalentë të pozicionit financiar. Shumat ekuivalente ponderohen për rrezikun duke përdorur përqindje të ndryshme (0%, 20%, 50%, 100%, dhe 150%) në varësi të klasave të ekspozuara. Metoda të ndryshme janë përdorur për të zvogëluar rrezikun si për shembull transaksione me kolateral dhe garanci. Kapitali rregullator i Bankës analizohet në dy kategori:

- Kategoria 1 e kapitalit (kapitali bazë), i cili përfshin kapitalin e aksioneve të zakonshme, primet e aksioneve, rezervat statutore, rezerva të tjera të përgjithshme, fitimi i akumuluar nga vitet e mëparëshme dhe interesi i pakicës pas zbritjes së emrit të mirë, aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe humbjet e parealizuara nga investimet e vlefshme për shitje.
- Kategoria 2 e kapitalit (kapitali plotësues), i cili përfshin borxhin e varur të kualifikuar, përkatësisht borxhin e vazhdueshëm si dhe borxhin e varur.

Kufizimet e mëposhtme aplikohen tek elementët e kapitalit bazë: Kategoria 2 e kapitalit nuk mund të jetë më e madhe se kategoria 1 e kapitalit dhe kapitali i huave të varura te kualifikuara nuk mund të jetë më i madh se 33.3% e kategorisë 1 të kapitalit. Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë te investuesit, kreditorët si dhe në treg, dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen. Impakti i nivelit të kapitalit në të ardhurat e aksionerëve është i njohur dhe Banka e pranon nevojën për të mbajtur një balancë midis mundësisë për më shumë të ardhura dhe avantazheve dhe sigurisë që vijnë nga një pozicion i qëndrueshëm kapitalit.

Drejtimi i Bankës bën monitorime të përditshme të gjithë aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimet e tregjeve ndërkombëtare duke aplikuar praktikat bankare më të mira. Mbi këtë bazë Drejtimi bën analiza mbi fitimin, likuiditetin dhe kostot e financimeve dhe implementon masat e duhura për rrezikun e kredisë, tregut (norma primare e interesit) dhe likuiditetit duke ulur kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një pozicion kapitali dhe likuiditeti të qëndrueshëm.

Banka ka qenë në përputhje me të gjithë kërkesat e vendosura nga palët e treta të jashtme për kapitalin përgjatë periudhës. Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritur sipas këtyre kërkesave më 31 dhjetor 2022 ishte 15.08% (31 dhjetor 2021: 16.20%) krahasuar me minimumin e vendosur nga Banka e Shqipërisë prej 12%.

5. Aktivet dhe detyrimet financiare

Klasifikimi kontabël dhe vlera e drejtë

Politika kontabël e Bankës për matjen e vlerës së drejtë shpjegohet në politikat kontabël 3.f.(vii).

Banka e përcakton vlerën e drejtë duke ndjekur rendin e mëposhtëm që reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në kryerjen e matjeve:

- Niveli 1: Çmimet e tregut të kuotuara (të pakorrigjuara) në një treg aktiv për instrumenta identik.
- Niveli 2: Metoda vlerësimi të bazuara në të dhënat të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejpërdrejtë (për shembull cmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull si rezultat i cmimit). Kjo kategori përfshin instrumenta të vlerësuar duke përdorur: cmimet e kuotuara në tregje aktive për instrumenta të njëjtë; çmimet e kuotuara për instrumenta identik ose të njëjtë në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose metoda vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejpërdrejtë të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Metoda vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentat ku metoda e vlerësimit merr parasysh faktorë bazuar në të dhëna jo të vëzhgueshme të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta të cilat janë vlerësuar në bazë të cmimeve të kuotuara për instrumenta të njëjtë ku korrigjime të pavëzhgueshme të konsiderueshme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumentave.

Metodat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve të parasë, krahasime me instrumenta të njëjtë për të cilat ekzistojnë cmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në ecurinë aktuale të "yield"-it të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit. Supozimet dhe faktorët e përdorur në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa risk dhe të tregut, normat e kredidhënies dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen normave të skontuara, obligacionet dhe cmimi i kapitalit, kurset e këmbimit, cmimi i kapitalit dhe cmimi i indeksuar i kapitalit dhe luhatjet e pritshme dhe të lidhura me njëra tjetrën. Objektivi i metodave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë e cila reflekton cmimet e instrumentave financiarë në datën e raportimit, që do të ishin përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg duke vepruar në kushte normale tregu.

Banka përdor modele vlerësimi gjerësisht të njohura për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumentave financiare të zakonshem dhe të thjeshte, si normat e interesit dhe këmbim monedhash të cilat përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe lënë pak vend për gjykim dhe vlerësim nga drejtimi. Cmime te vëzhgueshme dhe të dhëna për modele janë zakonisht të disponueshme në treg për borxhet e listuara dhe instrumentat e kapitalit. Disponimi i çmimeve të vëzhgueshme në treg dhe të dhënave për modele ul nevojën për vlerësime dhe gjykime nga drejtimi dhe gjithashtu ul pasigurinë që lidhet me përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponimi i cmimeve të tregut dhe të dhënave të vëzhgueshme ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është i prirur që të ndryshojë në bazë të ngjarjeve specifike dhe kushteve të përgjithshme në tregjet financiare.

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, të gjitha instrumentet financiare maten me koston e amortizuar, përveç aktiveve të vlefshme për shitje të cilat janë matur me vlerën e drejtë dhe vlerat përkatëse janë dhënë në shënimin 6. Të gjitha vlerat e drejta dhe detyrimet financiare të dhëna janë matur në bazë të hierarkisë së Nivelit 2.

5. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Klasifikimi kontabël dhe vlera e drejtë (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën kontabël dhe vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës:

Më 31 dhjetor 2022

	Shënimi	Të mbajtura me VDATGj	Investime me kosto të amortizuar	Hua dhe të arkëtueshme	Të mbajtura me kosto të amortizuar	Vlera kontabël gjithsej	Vlera e drejtë
Arka dhe balanca me Bankën Qëndrore	14	-	-	3,170,472	-	3,170,472	3,170,472
Balanca të kushtëzuara	15	-	-	3,268,442	-	3,268,442	3,268,442
Investime të mbatura me VDATGj gjithëpërfshirëse	16	3,616,033	-	-	-	3,616,033	3,616,033
Investime me kosto të amortizuar	16	-	9,093,158	-	-	9,093,158	8,601,817
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	17	-	-	3,730,441	-	3,730,441	3,730,441
Hua dhe paradhënie klientëve	18	-	-	25,231,137	-	25,231,137	25,231,137
Detyrime ndaj bankave	23	-	-	3,182,229	-	3,182,229	3,182,229
Detyrime ndaj klientëve	24	-	-	38,869,160	-	38,869,160	38,869,160
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	25	-	-	453,452	-	453,452	453,452
Borxhi i varur	26	-	-	-	1,133,621	1,133,621	1,133,621
Detyrimi për qiranë	27	-	-	-	801,739	801,739	801,739
Detyrime të tjera	28	-	-	-	418,160	418,160	418,160

5. Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Klasifikimi kontabël dhe vlera e drejtë (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	Të mbajtura me VDATGj	Hua dhe të arkëtueshme	Të mbajtura me kosto të	Vlera kontabël gjithsej	Vlera e drejtë
Arka dhe balanca me Bankën Qëndrore	14	-	898,338	-	**898,338**	**898,338**
Balanca të kushtëzuara	15	-	2,713,545	-	**2,713,545**	**2,713,545**
Investime të mbatura me VDATGj gjithëpërfshirëse	16	11,592,311	-	-	**11,592,311**	**11,592,311**
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve financiare	17	-	4,234,180	-	**4,234,180**	**4,234,180**
Hua dhe paradhënie klientëve	18	-	20,645,991	-	**20,645,991**	**20,645,991**
Detyrime ndaj bankave	23	-	424,467	-	**424,467**	**424,467**
Detyrime ndaj klientëve	24	-	34,332,798	-	**34,332,798**	**34,332,798**
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	25	-	886,539	-	**886,539**	**886,539**
Borxhi i varur	26	-	-	594,092	**594,092**	**594,092**
Detyrimi për qiranë	27	-	-	902,690	**902,690**	**902,690**
Detyrime të tjera	28	-	-	134,659	**134,659**	**134,659**

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve me to, si dhe e huave dhe paradhënieve për bankat është përafërsisht e barabartë me vlerën e mbartur, për shkak të maturitetit afatshkurtër të tyre. Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve për klientët është përafërsisht e barabartë me vlerën e mbartur, sepse shumica e portofolit të kredive ka norma interesi të ndryshueshme të cilat reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut.

6. Të ardhurat neto nga interesi

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme me to		
Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme me to lindin nga:		
Llogaritë dhe vendosjet me bankat	20,170	6,270
Kreditë për bizneset e vogla dhe të mesme	563,403	419,069
Kreditë për individët	919,412	705,677
Të ardhurat nga transaksionet me instrumenta investimi	435,430	449,631
	1,938,415	**1,580,647**
Shpenzime për interesat dhe të ngjashme me to		
Shpenzimet për interesa dhe të ngjashme me to lindin nga:		
Depozita nga bankat	(22,647)	(7,560)
Depozitat nga klientët	(284,606)	(308,234)
Marrëveshje të anasjellta të riblerjes	(6,152)	(3,529)
Interes mbi koston e aktiveve	(13,130)	(21,521)
Interesi i borxhit të varur	(23,232)	(23,757)
Kontratat e qirasë financiare	(21,818)	(23,673)
Amortizimi i primit për letrat me VDATGj	(20,067)	(31,978)
Amortizimi i primit për letrat me kosto të amortizuar	(14,399)	-
	(406,051)	**(420,252)**
Të ardhura nga interesi neto	**1,532,364**	**1,160,395**

Në zëra të ndryshëm të të ardhurave nga interesi më 31 dhjetor 2022 janë përfshirë në një shumë prej 195,719 mijë Lekë (2021: 217,778 mijë Lekë) interesa të përllogaritur nga kreditë e zhvlerësuara individualisht.

7. Të ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Të ardhurat nga komisionet dhe tarifat		
Llogaritë e klientëve	242,975	185,046
Transaksione dhe pagesa	64,351	63,172
Kartat për bizneset	114,449	71,157
Letrat e kreditit dhe garancitë	6,815	4,938
Të tjera	90,340	91,501
	518,930	**415,814**
Shpenzime për komisionet dhe tarifat		
Letrat e kreditit dhe garancitë	(1,245)	(784)
Kartat për bizneset	(68,171)	(51,145)
Llogaritë korespondente	(7,557)	(5,793)
Transaksione dhe pagesa	(2,632)	(2,449)
Borxhi i varur	(1,324)	(1,372)
Të tjera	(8,645)	(8,038)
	(89,574)	**(69,581)**
Të ardhurat neto nga komisionet	**429,356**	**346,233**

Në tarifat dhe komisione të tjera përfshihen tarifat e depozitarit, kujdestarisë dhe shërbimet e brokerimit në shumën 64,379 mijë lekë (2021: 61,903 mijë lekë). E para rrjedh nga ruajtja e aseteve të investimeve dhe fondeve të pensioneve për të cilat Fibank Albania shërben si depozitues. Tarifat e kujdestarisë krijohen nga shërbimi i ruajtjes së letrave me vlerë të institucioneve në emër të klientëve. Ndërkohë shërbimet e brokerimit përbëhen nga ndërmjetësimi për transaksionet me instrumentet financiare, duke përfshirë pjesëmarrjen në tregjet primare të letrave me vlerë të Qeverisë së Shqipërisë në emër të klientëve dhe ekzekutimin e transaksioneve në emër të fondeve të investimeve dhe pensioneve për të cilat Fibank Shqipëria shërben si depozitues.

8. Të ardhurat neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përbëhen nga fitimet dhe humbjet nga kurset e këmbimit, që përfshijnë të ardhurat neto nga rivlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj.

9. Të ardhura të tjera operative

Të ardhurat të tjera operative përbëhen nga të ardhurat neto nga shitja e investimeve të mbajtura me VDATGj në shumën prej 6,154 mijë Lekë (2021: 117,794 mijë Lekë).

10. Shpenzime personeli

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Paga	(363,743)	(321,338)
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore te detyrueshme	(50,584)	(43,481)
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore vullnetare	(5,878)	(3,693)
Shpenzime trajnimi	(4,951)	(3,694)
Shpenzime të tjera për stafin	(2,807)	(2,893)
Gjithsej	**(427,963)**	**(375,099)**

Për vitin që mbaron me 31 dhjetor 2022 Banka kishte të punësuar mesatarisht 392 punonjës (2021: 350 punonjës).

11. Shpenzime të përgjithshme administrative

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Publicitet dhe marrëdhënie me publikun	(33,377)	(23,447)
Mirëmbajtje dhe riparime	(40,335)	(36,068)
Kosto administrimi, konsultimi dhe të tjera	(111,757)	(100,757)
Kosto auditi	(2,696)	(2,027)
Gjithsej	**(188,165)**	**(162,299)**

Kosto administrimi, konsultimi dhe të tjera janë të detajuara si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Komunikimi	(7,018)	(6,669)
Utilitete	(14,619)	(14,688)
Pajisje zyre	(11,037)	(9,046)
Shpenzime sigurimi	(22,384)	(20,275)
Abonimet	(14,470)	(15,384)
Fondi i nderhyrjes së jashtëzakonshme	(14,727)	(12,890)
Të tjera	(27,502)	(21,805)
Gjithsej	**(111,757)**	**(100,757)**

12. Shpenzime të tjera, neto

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Kontributet e primit në skemën e sigurimit të depozitave	(103,975)	(94,346)
Gjoba dhe penalitete	(237)	(389)
Të ardhura të tjera/(shpenzime), neto	163,059	21,774
Total	**58,847**	**(72,961)**

13. Tatimi mbi fitimin

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Tatimi aktual	(139,141)	(102,951)
Tatimi i shtyrë	(6,217)	(3,674)
Tatimi fitimi mbi të ardhurat/(të ardhura)	**(145,358)**	**(106,625)**

Vlerat e përfshirë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Aktive financiare të mbajtura me VDATGj	54,116	6,655
Gjithsej	**54,116**	**6,655**

Më poshtë është një rakordim i normës efektive të tatimit:

	2022	Norma efektive e tatimit	2021	Norma efektive e tatimit
Fitim (Humbja) për periudhën	**879,149**		**615,306**	
Totali i tatimit mbi fitmin	145,358		106,625	
Fitimi duke përjashtuar shpenzimin e tatimit mbi fitimin	**1,024,507**		**721,931**	
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën e tatimit vendase	153,676	15.0%	108,290	15.0%
Shpenzime të pazbritshme	1,134	0.1%	1,269	0.2%
Të ardhura të patatueshme	(9,479)	-0.9%	(3,644)	-0.5%
Ndryshimi në diferencat e përkohshme	27	0.0%	710	0.1%
Gjithsej shpenzimi i tatimit	**145,358**	**14.2%**	**106,625**	**14.8%**

13. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Fitimi i periudhës para tatimit mbi të ardhurat	**1,024,507**	**721,931**
Shpenzime të pazbritshme	7,556	8,462
Shpenzime personeli	*2,807*	*2,893*
Shpenzime të tjera	*4,749*	*5,569*
Shpenzime amortizimi dhe zhvlerësimi	(5,600)	(7,257)
Të ardhura të patatueshme	(63,196)	(24,293)
Efekti i zbatimit të SNRF 16	(35,661)	(12,506)
Fitimi i tatueshëm	**927,606**	**686,337**
Tatim fitim i periudhës @ 15% (2021: 15%)	**(139,141)**	**(102,951)**

Tatimi i shtyre është përllogaritur sipas diferencave të përkoshme duke përdorur normën tatimore 15%. Ndryshimet në tatimin e shtyrë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

	2022	2021
Balanca më 1 Janar	**(19,665)**	**(22,646)**
Amortizimi i përshpejtuar i mjeteve fikse	(867)	(1,798)
Rivleresimi i investimeve në letra me vlerë	54,116	6,655
Efekti neto i zbatimit të SNRF 16	(5,349)	(1,876)
E ardhura (Detyrimi) tatimor i shtyrë	**28,235**	**(19,665)**

Tatimi i shtyrë i njohur më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 i atribuohet zërave të mëposhtëm:

	2022			2021		
	Aktive	Detyrime	Net	Aktive	Detyrime	Net
Amortizimi	1,984	-	**1,984**	2,851	-	**2,851**
Detyrimi për qiranë	120,261	-	**120,261**	135,404	-	**135,404**
Investime në letra me vlerë sipas VDATGj	29,968	-	**29,968**	-	(24,148)	**(24,148)**
Aktivi me të drejtë përdorimi	-	(123,978)	**(123,978)**	-	(133,772)	**(133,772)**
Aktivet / (Detyrimet) tatimore të shtyra, neto	**152,213**	**(123,978)**	**28,235**	**138,255**	**(157,920)**	**(19,665)**

14. Aktivet monetare dhe balancat me Bankën Qendrore

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Aktive monetare në arkë		
Në Lekë	259,368	335,708
Në monedhë të huaj	662,719	562,357
Balancat me Bankën Qendrore	2,248,385	273
Gjithsej	**3,170,472**	**898,338**

15. Balanca të kushtëzuara

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Rezerva e detyrueshme	3,268,442	2,713,545
Gjithsej	**3,268,442**	**2,713,545**

Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.13, datë 07.02.2018, minimum i rezervës së detyrueshme për depozitat e klientëve në Lekë është norma 7.5% dhe 5.0% respektivisht për depozitat me maturim me të vogël se 12 muaj dhe ato me maturitet ndërmjet 1 dhe 2 vitesh.

Ndërsa për depozitat e klientëve në monedhë të huaj minimumi i rezervës së detyrueshme është 12.5% nëse depozitat në monedhë të huaj jane më pak se 50% e totalit të depozitave të përfshira sipas rregullores së rezervës së detyrueshme dhe 20% për atë pjesë të depozitave në monedhë të huaj që kalojnë 50% të totalit të depozitave.

Me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.12, datë 07.02.2018, përcaktohet që deri në 70% e rezervës së detyrueshme në Lekë është e disponueshme për operacionet e përditshme të Bankës.

16. Investimet në letra me vlerë

a) Investime të mbajtura me VDATGj

Investimet në letrat me vlerë të mbajtura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet e qeverive shqiptare dhe të BE-së.

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Bono Thesari	977,783	1,547,968
Obligacione qeveritare	2,638,250	10,044,343
Gjithsej	**3,616,033**	**11,592,311**

Për Bonot e Thesarit zbritja me 31 Dhjetor 2022 ishte 945 mijë lekë (2021: 9,350 mijë). Më 31 Dhjetor 2022 për Obligacionet e Qeverisë zbritja ishte 1,980 mijë lekë (2021: 101,483 mijë) dhe interesat e përllogaritur ishin 31,830 mijë lekë (2021: 127,121 mijë).

Bonot e thesarit me vlerë nominale 478,000 mijë lekë (2021: obligacione thesari ALL 700,000 mijë dhe bono thesari ALL 300,000 mijë) shërbejnë si garanci për marrëveshjet e riblerjes. (Referojuni shënimit 25).

16. Investime në letrat me vlerë (vazhdim)

a) Investime të mbajtura me VDATGJ (vazhdim)

Gjatë vitit 2022, pas miratimit nga Këshilli Drejtues, në 1 maj 2022 Banka riklasifikoi obligacione të qeverisë shqiptare të mbajtura me VDATGj me vlerë kontabël 6,612,562 mijë lekë në investime në letra me vlerë të matura me kosto të amortizuar.

Ndryshimi i modelit të biznesit ishte në përputhje me strategjinë e bankës mëmë se çdo blerje e letrave me vlerë qeveritare synohet si aktivitet investimi, pasi drejtimi vlerëson se i përshtatet më mirë modelit të biznesit, objektivi i të cilit është mbledhja në maturim.

Banka nuk u angazhua në aktivitete në përputhje me modelin e mëparshëm të biznesit në lidhje me portofolin e riklasifikuar, pas riklasifikimit më 1 maj 2022 si dhe nuk shiti nga portofoli i riklasifikuar.

Drejtimi i Bankës vlerëson se është më e përshtatshme të ketë më shumë se një model biznesi për administrimin e instrumenteve të saj financiare, një qasje në përputhje me bankën e saj mëmë Fibank AD.

b) Investime në letra me vlerë të matura me kosto të amortizuar

Investimet në letra me vlerë të matura me kosto të amortizuar përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë shqiptare.

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Bono Thesari	1,406,329	-
Obligacione qeveritare	7,686,829	-
Gjithsej	**9,093,158**	**-**

Investimet në letra me vlerë të matura me koston e amortizuar përfshijnë 6,227,736 mijë lekë të riklasifikuara nga kategoria investime në letra me vlerë të matura nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse siç përshkruhet më sipër, vlera e drejtë e të cilave në datën e raportimit ishte 5,803,927 mijë lekë dhe fitimi ose humbja e lidhur me vlerën e drejtë që do të ishte njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës raportuese, nëse letrat me vlerë të nuk do të ishin riklasifikuar, është 682 mijë lekë.

17. Hua dhënë bankave dhe institucioneve financiare

(a) Analiza sipas llojit

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Llogaritë rrjedhëse me bankat	2,606,156	1,893,261
Vendosje në banka	1,124,100	2,340,760
Interesi i përllogaritur	185	159
Gjithsej	**3,730,441**	**4,234,180**

(b) Analiza gjeografike

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Bankat dhe institucionet financiare rezidente	910,136	2,340,919
Bankat dhe institucionet financiare jo-rezidente	2,820,305	1,893,261
Gjithsej	**3,730,441**	**4,234,180**

Bankat kryesore korresponduese të Bankës jashtë Shqipërisë janë Fibank AD në Bullgari dhe Raiffeisen Bank International AG në Austri.

Në 31 dhjetor 2022, Fibank AD është vlerësuar me B sipas Fitch, ndërsa Raiffeisen Bank International AG është vlerësuar me A2 sipas Moddy's.

(c) Analiza sipas monedhës

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
në Lekë	910,136	2,220,158
në Euro	2,366,139	1,177,041
në Dollarë Amerikanë	400,689	787,087
në monedha të tjera	53,477	49,894
Gjithsej	**3,730,441**	**4,234,180**

18. Hua dhe paradhënie për klientët

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Hua dhe paradhënie për klientët	26,213,730	21,591,197
Humbje nga zhvlerësimet	(982,593)	(945,206)
Huatë dhe paradhëniet për klientët neto	**25,231,137**	**20,645,991**

Kreditë sipas sektorëve më 31 dhjetor 2022 dhe 2021:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Individë	11,914,361	9,353,711
Hua konsumatore	2,376,801	*1,622,125*
Hua hipotekore	9,188,999	*7,382,127*
Karta Krediti	348,561	*349,459*
Bizneset e vogla dhe të mesme	14,299,369	12,237,486
Zhvlerësimet	(982,593)	(945,206)
Huatë dhe paradhëniet për klientët neto	**25,231,137**	**20,645,991**

Huatë dhe paradhëniet për klientët sipas sektorëve me 31 dhjetor 2022 ishin si më poshtë:

	Shuma bruto	Fondi për HPK-të	Vlera kontabël
Individë	11,914,361	(485,229)	11,429,132
Hua konsumatore	2,376,801	(184,063)	2,192,738
Hua hipotekore	9,188,999	(118,527)	9,070,472
Karta Krediti	348,561	(182,639)	165,922
Biznese të vogla dhe të mesme	14,299,369	(497,364)	13,802,005
Gjithsej	**26,213,730**	**(982,593)**	**25,231,137**

Huatë dhe paradhëniet për klientët sipas sektorëve më 31 dhjetor 2021 ishin si më poshtë:

	Shuma bruto	Fondi për HPK-të	Vlera kontabël
Individë	9,353,711	(461,069)	8,892,642
Hua konsumatore	*1,622,125*	*(147,387)*	*1,474,738*
Hua hipotekore	*7,382,127*	*(119,238)*	*7,262,889*
Karta Krediti	*349,459*	*(194,444)*	*155,015*
Bizneset e vogla dhe të mesme	12,237,486	(484,137)	11,753,349
Gjithsej	**21,591,197**	**(945,206)**	**20,645,991**

18 Hua dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

Ndryshimet në fondin për humbje nga zhvlerësimi për 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

	2022	2021
Niveli 1		
Balanca 1 janar	(217,468)	(177,611)
(Humbje nga zhvlerësimi) / rimarrje për vitin	(170,619)	(39,857)
Shpenzimi për vitin	(226,406)	(100,568)
Rimarrje	55,787	60,711
Fshirjet	-	-
Balanca 31 dhjetor	**(388,087)**	**(217,468)**
Niveli 2		
Balanca 1 janar	(208,829)	(202,335)
(Humbje nga zhvlerësimi) / rimarrje për vitin	77,252	(6,494)
Shpenzimi për vitin	(116,793)	(157,361)
Rimarrje	194,045	150,867
Fshirjet	-	-
Balanca 31 dhjetor	**(131,577)**	**(208,829)**
Niveli 3		
Balanca 1 janar	(518,909)	(430,130)
(Humbje nga zhvlerësimi) / rimarrje për vitin	(179,013)	(133,909)
Shpenzimi për vitin	(242,249)	(214,299)
Rimarrje	63,236	80,390
Fshirjet	234,993	45,130
Balanca 31 dhjetor	**(462,929)**	**(518,909)**
Provizione gjithsej	**(982,593)**	**(945,206)**

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara

	Ndërtesa dhe Përmirësime në ambiente me qira	Paisje dhe instalime	Mjete motorike	Paisje zyre dhe elektronike	Kompiutera dhe paisje për sistemin IT	Paisje zyre dhe të tjera	Aktive të qëndrueshme në proces	Gjithsej
Kosto								
Gjëndja më 1 janar 2021	**1,191,411**	**92,815**	**21,465**	**123,614**	**142,776**	**72,707**	**8,577**	**1,653,365**
Shtesat	72,552	6,738	-	17,335	1,183	1,474	7,185	106,467
Pakësimet	(31,040)	(90)	(1,465)	(235)	-	-	-	(32,830)
Transferimet	-	-	-	595	-	-	(595)	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2021	**1,232,923**	**99,463**	**20,000**	**141,309**	**143,959**	**74,181**	**15,167**	**1,727,002**
Shtesat	191,119	2,746	15,529	10,973	4,545	1,734	7,026	233,672
Pakësimet	(12,528)	-	(6,010)	(845)	(13,522)	(23)	-	(32,928)
Transferimet	1,746	338	-	1,382	2,498	909	(6,873)	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2022	**1,413,260**	**102,547**	**29,519**	**152,819**	**137,480**	**76,801**	**15,320**	**1,927,746**
Amortizimi i akumuluar								
Gjëndja më 1 janar 2021	**(256,228)**	**(54,151)**	**(13,947)**	**(91,777)**	**(104,332)**	**(52,249)**	**-**	**(572,684)**
Amortizimi i periudhës	(77,563)	(5,577)	(1,324)	(4,342)	(12,616)	(2,786)	-	(104,208)
Pakësimet	30,140	60	1,465	190	-	-	-	31,855
Gjëndja më 31 dhjetor 2021	**(303,651)**	**(59,668)**	**(13,806)**	**(95,929)**	**(116,948)**	**(55,035)**	**-**	**(645,037)**
Amortizimi i periudhës	(78,406)	(5,450)	(1,309)	(6,061)	(13,177)	(2,842)	-	(107,245)
Pakësimet	7,419	-	5,315	845	13,430	23	-	27,032
Gjëndja më 31 dhjetor 2022	**(374,638)**	**(65,118)**	**(9,800)**	**(101,145)**	**(116,695)**	**(57,854)**	**-**	**(725,250)**
Vlera kontabël								
Më 1 janar 2021	**935,183**	**38,664**	**7,518**	**31,837**	**38,444**	**20,458**	**8,577**	**1,080,681**
Më 31 dhjetor 2021	**929,272**	**39,795**	**6,194**	**45,380**	**27,011**	**19,146**	**15,167**	**1,081,965**
Më 31 dhjetor 2022	**1,038,622**	**37,429**	**19,719**	**51,674**	**20,785**	**18,947**	**15,320**	**1,202,496**

19. Aktive të qëndrueshme të trupëzuara (vazhdim)

Të tjera

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në proces përfshijnë të gjitha aktivet e blera që nuk janë vënë ende në përdorim. Përmirësime në ambientet me qira përfshijnë investime të bëra në ambientet e mara me qira.

Në 31 dhjetor 2022 në vlerë kontabël neto për aktivet afatgjata të trupëzuara përfshihen dhe aktivet me të drejtë përdorimi si më poshtë:

	Kosto	Amortizimi i akumuluar	31 Dhjetor 2022
Zyrat	1,050,532	(248,190)	**802,342**
Magazina dhe objekte të tjera	34,896	(10,720)	**24,176**
Aktive me të drejtë përdorimi	**1,085,428**	**(258,910)**	**826,518**

Në 31 dhjetor 2021 në vlerë kontabël neto për aktivet afatgjata të trupëzuara përfshihen dhe aktivet me të drejtë përdorimi si më poshtë:

	Kosto	Amortizimi i akumuluar	31 Dhjetor 2021
Zyrat	1,058,306	(186,376)	**871,930**
ATM, magazina dhe objekte të tjera	28,102	(8,223)	**(19,879)**
Aktive me të drejtë përdorimi	**1,086,408**	**(194,599)**	**891,809**

20. Aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara

	Patenta dhe licensa	Software dhe të tjera	Aktive të patrupëzuara në proces	Gjithsej
Kosto				
Gjëndja më 1 janar 2021	**18,098**	**126,472**	**4,015**	**148,585**
Shtesat	567	9,359	6,282	**16,208**
Transferimet	-	603	(603)	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2021	**18,665**	**136,434**	**9,694**	**164,793**
Shtesat	5,587	14,618	5,004	**25,209**
Transferimet	1,550	4,456	(6,006)	-
Pakësimet	(3,662)	(30,781)	-	**(34,443)**
Gjëndja at 31 dhjetor 2022	**22,140**	**124,727**	**8,692**	**155,559**
Amortizimi i akumuluar				
Gjëndja më 1 janar 2021	**(12,775)**	**(71,108)**	-	**(83,883)**
Amortizimi i periudhës	(1,941)	(14,006)	-	(15,947)
Gjëndja më 31 dhjetor 2021	**(14,716)**	**(85,114)**	-	**(99,830)**
Amortizimi i periudhës	(2,016)	(15,756)	-	(17,772)
Pakësimet	3,662	30,781	-	34,443
Gjëndja më 31 dhjetor 2022	**(13,070)**	**(70,089)**	-	**(83,159)**
Vlera kontabël				
Më 1 janar 2021	**5,323**	**55,364**	**4,015**	**64,702**
Më 31 dhjetor 2021	**3,949**	**51,320**	**9,694**	**64,963**
Më 31 dhjetor 2022	**9,070**	**54,638**	**8,692**	**72,400**

21. Aktive të mbajtura per shitje

Aktivet e mbajtura për shitje janë kolateralet e marra nëpërmjet ekzekutimit të garancive për huatë dhe paradheniet me probleme të klientëve. Këto aktive të marra përbëhen nga një numër pronash përfshirë toka dhe ndërtesa të cilat nuk janë dhënë me qira apo të përdoren nga vetë Banka. Gjatë 2022 Banka testoj pronat për zhvlerësim të mundshëm dhe rezultoj që nuk ishte i nevojshëm ndonjë zhvlerësim (2021: asnjë)

Ndryshimet në aktivet e riposeduara gjatë periudhës raportuese janë paraqitur si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Në fillim të periudhës	**547,372**	**479,221**
Shtesat gjatë periudhës	148,575	89,962
Pakësimet gjatë periudhës	(77,540)	(21,811)
Gjithsej	**618,407**	**547,372**

Pakësimet përfaqësojnë pronat e shitura nga Banka në 2022.

22. Aktive të tjera

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Tatime të parapaguara	48,721	48,721
Shpenzime të shtyra	23,341	19,161
Shufra ari	2,399	3,269
Të tjera	16,606	33,478
Gjithsej	**91,067**	**104,629**

Tatimi i parapaguar është i përbërë si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Tatimi në burim	48,721	48,721
Tatimi mbi fitimin i parapaguar	-	-
Gjithsej	**48,721**	**48,721**

Parapagimi për tatimin në burim është i lidhur me të ardhurat nga interesi që Banka ka gjeneruar në shtete me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje për Mënjanimin e Tatimit të Dyfishtë.

23. Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Llogari rrjedhëse	13	424,467
Depozita me afat	3,182,216	-
Gjithsej	**3,182,229**	**424,467**

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
në Lekë	665,178	424,458
në monedhë të huaj	2,517,051	9
Gjithsej	**3,182,229**	**424,467**

Detyrimet ndaj bankave janë llogaritë rrjedhëse të bankave vendase të cilat nuk janë të vlerësuara, dhe depozita me afat janë me afat me Fibank AD, e cila sipas Fitch është e vlerësuar me B në 31 dhjetor 2022.

24. Detyrime ndaj klientëve

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Individë	**29,483,005**	**28,157,983**
Llogari rrjedhëse dhe kursimi	*11,483,176*	12,443,081
Depozita me afat	*17,999,829*	15,714,902
Klientë të Korporatave	**9,386,155**	**6,174,815**
Llogari rrjedhëse dhe kursimi	*7,442,476*	4,220,685
Depozita me afat	*1,527,614*	1,329,660
Llogari të tjera klientësh	*416,065*	624,470
Gjithsej	**38,869,160**	**34,332,798**

25. Marrëveshje të anasjellta të riblerjes

Banka ka pasur marrëveshje të anasjellta riblerje më 31 dhjetor 2022 me një vlerë kontabël 453,452 mijë lekë (31 dhjetor 2021: ALL 886,539 mijë). Këto janë marrëveshje 2 javore me institucione financiare residente me interes 2.60% në vit.

Bono thesari me vlerë nominale 478,000 mijë lekë (2021: obligacione thesari me vlerë nominale 700 000 mijë lekë dhe bono thesari me vlerë nominale 300 000 mijë lekë) u vunë peng për këto marrëveshje. (Referojuni shënimit 16).

26. Borxhi i varur

Më 11 janar 2019, asambleja e pergjithshme e aksionereve aprovoi emetimin e instrumentave të borxhit të varur në monedhën EUR për individët privat. Në 31 Dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 instrumentat janë të detajuar si më poshtë.

Monedha	Njësi	31 Dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EURO	490	1,133,621	594,092
Totali	**490**	**1,133,621**	**594,092**

Transhi	Data e emetimit	Data e maturimit	Norma e interesit	Njësi	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
1	25.04.2019	25.04.2026	4.5%	200	230,310	243,483
2	18.06.2020	18 .06.2027	3.5%	290	331,653	350,609
3	22.12.2022	22.12.2029	4.0%	500	571,658	-
Totali					**1,133,621**	**594,092**

27. Detyrimi për qiranë

Banka ka marrë me qira ndërtesat e zyrave dhe depo dhe objekte të tjera. Këto qira pasqyrohen në bilanc si një aktiv me të drejtë përdorimi dhe një detyrim për qiranë.

Banka i paraqet aktivet me të drejtë përdorimi si një zë më vete ne bilanc.

Tabela më poshtë përshkruan natyrën e aktiviteteve të qiramarrjes së Bankës sipas llojit të aktivit me të drejtë përdorimi të njohur në bilanc:

Aktivi me të drejtë përdorimi	Numri i aktiveve me të drejtë përdorimi	Kohëzgjatja e mbetur	Kohëzgjatja mesatere kontratave	Numri i kontratave me të drejtë rinovimi	Numri i kontratave me të drejtë blerje	Numri i kontratave me pagesa variable të lidhura me një indeks	Numri i kontratave me opsion nderprerje je
Ndërtesa	16	1-17 vjet	10 vjet	16	-	-	-
Magazina & ATM	25	1-9 vjet	3 vjet	25	-	-	-

28. Detyrimi për qiranë (vazhdim)

Detyrimet për qiranë janë të siguruara nga asetet me të drejtë përdorimi përkatëse. Pagesat e ardhshme të qirasë në 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë si vijon:

31 dhjetor 2022	Brenda 1 viti	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Pagesat e qirasë	79,313	295,361	575,339	950,013
Shpenzime interesi	(19,542)	(62,148)	(66,584)	(148,274)
Vlera aktuale neto	**59,771**	**233,213**	**508,755**	**801,739**

31 dhjetor 2021	Brenda 1 viti	1-5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Pagesat e qirasë	86,129	315,965	678,372	1,080,466
Shpenzime interesi	(22,041)	(71,665)	(84,070)	(177,776)
Vlera aktuale neto	**64,088**	**244,300**	**594,302**	**902,690**

Ndryshimet në detyrimet për qiranë që vijnë nga aktiviteti financues paraqiten si më poshtë:

	2022	2021
Më 1 janar	**902,690**	**924,238**
Flukset e parasë		
Ripagimet e principalit	(62,170)	(65,497)
Ndryshime	6,397	64,427
Jo- monetare	(45,178)	(20,478)
Më 31 dhjetor	**801,739**	**902,690**

28. Detyrime të tjera

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Llogari provizore	402,459	124,400
Kreditorë të tjerë	400,675	267,298
Administrata fiskale	51,809	61,651
Detyrime tatimore	14,427	23,585
Deyrimet ndaj personelit	7,926	6,216
Shpenzime të përllogaritura	278	-
Furnitorët	7,775	4,043
Gjithsej	**885,349**	**487,193**

29. Kapitali dhe rezervat

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 kapitali i regjistruar i Bankës ishte 11,974,576.26 Euro ose ekuivalenti në Lekë 1,516,517 mijë Lekë e ndarë në 1,413,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale secila prej 8.47457626 Euro ose 1,073.26 Lekë.

Rezerva të tjera

Në bazë të vendimit nr. 69, datë 18 dhjetor 2014, për Kapitalin Rregullator të Bankës të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, bankat dhe degët e bankave të huaja krijojnë rezerva prej 1.25% deri në 2% të aktiveve të ponderuara me rrezik, duke zbritur një të pestën e fitimit pas taksave dhe para shpërndarjes së dividentëve.

Rezerva rregullative prej 249,080 mijë lekë (2021: 201,084 mijë lekë) është krijuar deri në fund të dhjetorit 2022.

Rezerva ligjore

Në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare", shoqëritë duhet të krijojnë rezervë ligjore deri në 10% të kapitalit të regjistruar, duke zbritur të paktën 5% nga fitimi neto i periudhës së mëparshme, përpara se të shpërndajnë dividentë.

Rezerva ligjore prej 133,639 mijë lekë (2021: 102,874 mijë lekë) është krijuar deri në fund të dhjetorit 2022.

30. Pasive të kushtëzuara dhe angazhime

a) Zëra garancie

Banka jep garanci financiare dhe letra krediti për të garantuar performancën e klientëve për palët e treta. Këto marrëveshje kanë limite fikse dhe zakonisht janë për një periudhë deri në dy vjet. Shumat kontraktuale të garancive dhe angazhimeve janë paraqitur në tabelën më poshtë sipas kategorive. Shumat e paraqitura më poshtë për garancitë dhe letrat e kreditit paraqesin maksimumin e humbjes kontabël që do të njihet në datën e raportimit nëse secila nga palët dështon plotësisht në përmbushjen e detyrime sipas termave kontraktuale.

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Garanci bankare	272,803	174,270
Garanci dhënë klientëve	1,228,474	818,779
Leter kredi	-	-
Gjithsej	**1,501,277**	**993,049**

Këto garanci dhe angazhime kanë rrezik kredie për zërat jashtë bilancit sepse vetëm pagesat organizative dhe humbjet e mundëshme të përllogaritura janë njohur në bilanc derisa këto angazhime të plotësohen ose të maturohen. Shumë nga garancitë dhe angazhimet maturohen pa u përdorur plotësisht ose pjesërisht. Kështu që shumat nuk përfaqësojnë flukse dalëse të pritshme. Në datën e bilancit nuk ka garanci dhe angazhime për të cilat është e nevojshme ndonjë paraqitje shtesë. Më 31 dhjetor 2022 garancitë dhe letrat e kreditit janë plotësisht të siguruara me kolateral.

31. Palët e lidhura

Palët konsiderohen të jenë palë të lidhura nëse një palë ka mundësinë të kontrollojë ose të ushtrojë influencë mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët. Një numër transaksionesh bankare janë bërë me palën e lidhur Banka e Parë e Investimeve A.D. Bullgari në rrjedhën normale të biznesit. Kjo palë e lidhur kualifikohet si shoqëria mëmë e Bankës. Këto transaksione përfshijnë hua, depozita dhe transaksione të tjera. Balancat në fund të periudhave respektive janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më	
	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Hua dhe parapagime	2,787,101	1,834,441
Llogari të arkëtueshme	8,118	8,460
Detyrime	2,513,060	-
Të ardhurat nga interesi	7,151	-
Shpenzime per interesat	(13,015)	(7,357)
Të ardhura nga komisionet	399	482
Shpenzime për komisionet	(250)	(113)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, punonjësit kryesor të drejtimit të Bankës morën shpërblime në shumën prej 25,654 mijë Lekë (2021: 26,228 mijë Lekë). Drejtuesit morën përfitime të tjera në shumën 5,010 mijë Lekë gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2022 (2021: 7,494 mijë Lekë).

32. Aktive monetare dhe ekuivalente me to

	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
Aktive monetare në arkë (shënimi 14)	922,088	898,066
Llogaritë rrjedhëse		
Banka Qendrore (shënimi 14)	2,248,384	273
Bankat korrespondente (shënimi 17)	2,606,156	1,893,261
Huatë dhe paradhëniet dhënë bankave dhe institucioneve financiare, me maturitet më të vogël se 90 ditë (shënimi 17)	1,124,285	2,340,918
Gjithsej	**6,900,913**	**5,132,518**

33. Ngjarjet pas datës së bilancit

Drejtimi i Bankës nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje të mëvonshme që do të kërkonte rregullime ose paraqitje shtesë në pasqyrat financiare.